

RAPORT

I VLERËSIMIT TË JASHTËM


Për Programin e studimit MSc “Fizioterapi Klinike”

Ofruar nga Universiteti Aldent

Ekspertët e vlerësimit të jashtëm:

Prof. Dr Dhimitraq Stratobërdha

Phd Migena Kika



(Qershor/2018)

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për Programin e studimit MSc Fizioterapi Klinike

Tabela e të dhënave të licencimit për programin e studimit:		
1	IAL Aplikues:	Universiteti Aldent
2	Fakulteti që e ofron	Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike
3	Urdhëri/VKM i licencimit	UMAS Nr 195, dt 28.05.2013
4	Titulli i programit të studimit:	Master i Shkencave në Fizioterapi Klinike
5	Cikli i studimit:	Cikli I dytë
6	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite akademike
7	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
8	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	Me kohë të plotë
9	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha Shqip
10	Programi ofrohet nga institucioni	Ofrohet nga Institucioni
11	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	-
12	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
13	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
14	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	Niveli 7 (shtatë)
15	Aktivizimi i programit të studimit	2016-2017
16	Brezi i parë i diplomimit të studentëve	Nuk ka të diplomuar
17	Numri aktual i studentëve	76 studentë
	etj	

Shenim: Tabela plotësohet nga Specialisti i ASCAL

HYRJE

Raporti i Vlerësimit të Jashtëm i hartuar nga Ekspertët e vlerësimit, bazohet në të dhënat e sjella nga Institucioni në Raportin e Vlerësimit të brendshëm, anekseve përkatëse të këtij Raporti, vizitës dy ditore të zhvilluar në Institucion më datë 24 dhe 25 Prill 2018. Gjatë vizitës në institucion, Grupi i Vlerësimit të jashtëm kërkoi dokumentacion plotësues për disa sqarime për rubrika të veçanta të RVB. Ky dokumentacion u ngarkua në sistemin AMS nga koordinatorja e Institucionit. Materialet u hodhën në hapin përkatës nga koordinatorja teknike e ASCAL.

Ekspertë të vlerësimit për këtë program studimi të zgjedhur nga Bordi I Akreditimit dhe ASCAL janë:

Prof Dr Dhimitraq Stratobërdha

Phd Migena Kika

Gjatë gjithë procedurës, ekspertët e jashtëm të vlerësimit janë asistuar nga Koordinatori Teknik i ASCAL: Znj. Suela Kromidha

Me datë 31.05.2018 është dërguar në Institucion Draft Raporti i Vlerësimit të jashtëm i hartuar nga ekspertët e vlerësimit.

Më datë 05.06.2018, me shkresë nr 108/7 prot, Institucioni sjell në ASCAL komentet në lidhje me Draft – RVJ. Ekspertët e vlerësimit u njohën me këto komente dhe kanë përgatitur përgjigjen, duke konkluduar si më poshtë:

1. Për Rubrikën 2 nga ana e jonë si Ekspertë I qëndrojmë konkluzionit tonë dhe nuk bëjmë ndryshime në Raport.
2. Për Rubriken 3, nga GVJ u arrit në konkluzion si më poshtë:

Konkluzionet e vlerësimit:

Struktura didaktike për departamentet ose programin e studimit është optimale e sipas standardeve. Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe Personelit Akademik me Kontratë (PAK), titujt/gradat, plotësojnë nevojat e realizimit të programit

Cilësia e stafit drejtues, mësimdhënës dhe administrativ për programin e studimit është në përputhje me kërkesat e e vendosuar nga Institucioni. Si staf mësimdhënës paraqiten edhe lektorë me titull Msc, që kanë përvojë dhe eksperiencë disa vjeçare dhe shumica e tyre kanë mbaruar studimet Master në vendet e BE-së, gjë që nuk e cënon realizimin me cilësi të programit të studimit, por shikohet si një potencial i gatshëm për studimet e thelluara në Doktoraturë sapo MASR të nxjerrë kuotat për vijimësinë e studimeve, duke u mbështetur financiarisht edhe nga Universiteti Aldent qoftë edhe në vendet e BE-së ku ato kanë kryer studimet Msc. Realiteti është që në tregun shqiptar mungojnë pedagogë me titull dhe grada pasi programi i Fizioterapisë është mesatarisht program I ri.

Ishte në Draft RVJ

(Në dosjet e personelit përzgjedhur në mënyrë rastësore vihet re se disa CV kishin nevojë për tu përditësuar cka rekomandohet të bëhet në të ardhmen.)

Kjo zëvendësohet me fjalinë: Tashmë është krijuar një bazë të dhënash elektronike të dokumentacionit për cdo pjestar të stafit akademik, si CV, aktivitet shkencor, kualifikime etj.

Standardet plotësohen

3. Për Rubriken 7, nga ana e jonë u arrit në konkluzion si më poshtë:

Konkluzionet e vlerësimit:

Në këtë program studimi angazhohen personel akademik që janë me titull Msc, edhe pse shumica prej tyre kanë eksperiencë në mësimdhënie, prap kjo është në kundërshtim me Ligjin e arsimit të Lartë 80/2015, neni 59 pika 6 “Personeli akademik, që anagazhohet në mësimdhënie, duhet të ketë së paku kualifikim të ciklit pasardhës.” Por duke iu referuar tabelave të Stafit akademik të programit të studimit për vitin akademik 2017-18 krahasuar me 2016-17 ka ndryshime me përmirsim të dukshëm në rekrutimin e stafit, angazhim I dukshëm I drejtuesve të UAL në këtë drejtim. Nga Drejtuesit e Institucionit na u konfirmua angazhimi I këtij Institucioni për mbështetjen e stafit për rritjen e kualifikimit të tyre në programet Dr apo edhe rekrutime të reja me tituj dhe grada shkencore.

Studimet në këtë program organizohen në module dhe vlerësohen në kredite (ECTS). Vlerësimi i studentëve realizohet nëpërmjet kontrollit të njohurive të ndërmjetëme dhe të vazhdueshme si dhe provimet përfundimtare. Ky program studimi është një nevojë e kohës e tregut të punës dhe përgatitja e profesionistëve do të ndikojë në rritjen e cilësisë së shërbimit shëndetësor në vendin tone. Për tezën e diplomës janë parashikuar 20 kredite ECTS në planin mësimor dhe studenti për zgjedh vetë fushën e studimit për temën.

Standardet plotësohen kryesisht

Të dhëna për programin e studimit Msc në Fizioterapi Klinike

Universiteti “Aldent” (UAL) është licencuar në vitin 2003, si shkollë profesionale për programin e studimit “Laborant Dentar” – cikël 2 vjeçar dhe në vitin 2006 me VKM nr.673, dt.27.09.2006 si Shkollë e Lartë Universitare “Aldent”.

Në dt.13/06/2013, me VKM nr.539, UAL fiton Statusin Universitet dhe në mars të vitit 2016 është akredituar institucionalisht nga APAAL me ekspertë ndërkombëtar dhe vlefshmëria e këtij akreditimi është deri në 2022. Universiteti ju nënshtroa edhe vlerësimit institucional nga QAA dhe vlefshmëria e akreditimit institucional është deri në vitin 2022

UAL është një universitet i specializuar në fushën e mjekësisë, me një strategji zhvillimi të fokusuar vetëm në këtë drejtim. Në këto vite UAL ka patur zhvillime të vazhdueshme në shumë aspekte: shtim të numrit të mjekëve me eksperiencë të gjatë në mësimdhënie dhe praktikë klinike në përbërje të stafit akademik, rritje të numrit të studentëve, numrit të programeve të studimit të akredituara, rritje të numrit të laboratorëve e zgjerim të sipërfaqes e ambjenteve për sigurimin e standardeve bashkëkohore.

Universiteti “Aldent” përbëhet aktualisht nga tre fakultete:

- Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike
- Fakulteti i Shkencave Dentare
- Fakulteti i Shkencave Mjekësore

Ecuria e programit të studimit

Për ecurinë e këtij programi studimi, Dekania e Fakultetit të Shkencave Teknike Mjekësore Dr Nedime Cekagjatë takimit me Grupin e vlerësimit të jashtëm informon këtë Grup për të gjithë kronologjinë që ka patur ky program studimi, duke paraqitur një korespondencë shkresore të Institucionit me Agjencinë Kombëtare të Provimeve, Ministrinë e Arsimit dhe së fundmi me Qendrën e Shërbimeve Arsimore dhe konkretisht: Me Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës Nr 195, dt 28.5.2013 është licensuar

programi i studimit të ciklit të dytë "Master i Shkencave" në "Fizioterapi Klinike" (2 vite akademike - 120 kredite ECTS). Ky program është hapur në vitin akademik 2013-2014 dhe në të u regjistruan 15 studentë, emrat e të cilëve janë dërguar edhe në AKP për pajisjen me numër matrikullimi. Pas fillimit të mësimit këta studentë nuk frekuentuan rregullisht mësimin dhe me gjithë insistimin e Institucionit pjesmarrja e tyre linte për të dëshiruar. Referuar Rregullores së Universitetit dhe syllabuseve të lëndëve, këta 15 studentë nuk mund të kualifikoheshin për këtë vit akademik (2013-2014). Në këto kushte, Universiteti merr masën e përjashtimit të tyre dhe rrjedhimisht ky program nuk mund të vazhdonte më për vitin akademik 2013-2014. Për këtë arsye me Vendim Senati Nr 05/14 dt 26.01.2014, u vendos që ky program studimi mostë aktivizohet për vitin akademik 2013-2014. Me shkresë nr 52/16 prot, datë 30.11.2016, Universiteti Aldent i drejtohet Agjencisë Kombëtare të Provimeve (AKP) për tu paisur me numër matrikullimi studentët që ndiqnin këtë program studimi për Vitin Akademik 2016-2017. Me shkresë nr 2806 prot, datë 30.12.2016, AKP I drejtohet Universitetit Aldent duke dërguar numrat e matrikullimit për ciklin e parë për vitin akademik 2016-2017, ndërsa për këtë program studimi citon se: *Ju bëjmë me dije se për ciklin e studimit Master Shkencor nuk janë përcaktuar kuota për programin e studimit "Fizioterapi Klinike" nga MAS. Me shkresë nr 11, datë 17.01.2017, UA I drejtohet AKP dhe për dijëni edhe Sekretarit të Përgjithshëm të MAS, ku citon se ky Institucion i është drejtuar MAS me shkresë zyrtare duke kërkuar 40 kuota për programin e studimit Msc Fizioterapi Klinike për vitin akademik 2016-2017. Gjithashtu Institucioni citon se Për kuotat e vitit akademik 2016-2017 jemi kontrolluar nga grupi I punës për verifikimi e kapaciteteve pritëse për pranimet në programet e studimit, sipas kuotave të deklaruara në MAS, ku tregohet që verifikimet janë bërë edhe për këtë program (Urdhër Nr 356 e shkresës Nr 6499 prot, dt 27.06.2016).* Më datë 11.11.2016 është sjellë në UA Raporti përfundimtar për verifikimin e kapaciteteve pritëse për pranimet në programet e studimit për vitin 2016-2017, ku përsëri tregohet se ky Institucion është kontrolluar për kapacitetet pritëse dhe për programin e studimit "Master I Shkencave" në "Fizioterapi Klinike". Me shkresë Nr 84 prot, datë 17.07.2017, Universiteti Aldent I është drejtuar sërish Drejtorisë së Shërbimeve Juridike në Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve duke kërkuar interpretim juridik dhe duke paraqitur në këtë shkresë të gjithë kronologjinë e këtij programi studimi. Me shkresë Nr 1888/1, dt 04.09.2017, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Drejtorja e Bazës së të dhënave dhe sistemeve dërgon në Universitetin Aldent numrat e matrikullimit për studnetët e ciklit të dytë, Master Shkencor, Fizioterapi Klinike për vitin akademik 2016-2017. E gjithë praktika ju vu në dispozicion hard copy Grupit të vlerësimit të jashtëm gjatë vizitës në institucion. Aktivizimi i këtij programi nisi në vitin akademik 2016-2017, duke shënuar tanimë vitin e tij të dytë të veprimtarisë.

Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë, në UAL është pjesë përbërëse e Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike duke vepruar si bazë mësimore dhe kërkimore. Për akreditimin e programit, Universiteti "ALDENT" i është drejtuar Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë të Arsimit të Lartë (ASCAL) më 09.10.2017 me shkresë Nr. 107 Prot.

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)

Përbërja e GVJ:

- Prof. Dr Dhimitraq Stratobërdha
- Phd Migena Kika

Menaxhere teknike e ndjekjes së vlerësimit të kësaj procedure është specialistja e ASCAL, Suela Kromidha

Rubrika 1 - Misioni/Objektivat e programit të studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Qëllimet dhe objektivat e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, strategjitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, ndjekja dhe përshtatja e objektivave dhe e qëllimeve me kohën, të dhëna të përgjithshme për IAL.

Masteri i Shkencave në "Fizioterapi Klinike" organizohet nga Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike. Ky program studimi ofron një formim të specializuar, për të përgatitur figura profesionale të afta për të mbuluar me sukses role drejtuese të njëjësive operative rehabilituese në sektorin publik dhe privat. Në këtë Fakultet ofrohet diplomë e Ciklit të Parë (Bachelor) në "Fizioterapi" si dhe program Studimi I ciklit të Dytë Master i Shkencave në "Fizioterapi Klinike".

Gjatë takimeve me drejtuesit e këtij institucioni na u theksua se: Programi Master i Shkencave është hartuar në përputhje me misionin dhe qëllimin e Universitetit, për të kontribuar në zhvillimin e arsimit të lartë shqiptar, me një arsimim cilësor, edukim me vlerat më të mira morale dhe zhvillimin e kërkimit shkencor. Programi i studimit Master i Shkencave në Fizioterapi Klinike synon që studentët të pajisen me bazat shkencore teorike e praktike të nevojshme për ushtrimin e profesionit në praktikën e përditëshme klinike. Qëllimi I këtij programi ishte përgatitja e profesionistëve në fushën e fizioterapisë, me njohuri e kompetenca të nevojshme fizioterapeutike profesionale, teorike dhe praktike, të aftë të punojnë në mënyrë të pavarur në sektorin e reabilitimit, në përputhje me standardet bashkëkohore.

Gjatë takimeve në Institucion me drejtuesit e saj, u theksua gjithashtu se programi i studimit Msc. në Fizioterapi Klinike është ndërtuar mbi bazën e njohurive të marra në programin e studimit "Bachelor" në "Fizioterapi", duke pasuruar më tej njohuritë teorike dhe praktike kryesisht në lëndët e formimit profesional, si Teknikat Bazë të Fizioterapisë, Rehabilitimi në Neurologji dhe Neurokirurgji, Rehabilitimi në Ortopedi dhe Traumatologji, Rehabilitimi në Geriatri e Pediatri.

Në takimet e GVB me Dekanan e Fakultetit Dr Nedime Ceka, GVJ u citua se në funksion të qëllimit dhe objektivave të programit të studimit Master i Shkencave në Fizioterapi Klinike dhe rolit që kanë institucionet e arsimit të lartë në dobi të shoqërisë ku zhvillojnë aktivitetin e tyre, Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë ka kryer aktivitete të vazhdueshme në fushën e mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe kontributit për shoqërinë. Këto aktivitete përfshijnë trajnime brenda dhe jashtë shtetit, konferenca, seminare, aktivitete sociale e kulturore me profesorë vendas e të huaj.

Gjithashtu Grupi I vlerësimit të jashtëm u informua nga Rektori I Institucionit në takimin e realizuar më të se në strategjinë e Programit të studimit në Master i Shkencave në Fizioterapi Klinike, janë përfshirë:

- Përmirësimi i planeve dhe programeve mësimore ekzistuese
- Përmirësimi i vazhdueshëm i strukturës akademike ekzistuese.
- Shtimi i bazës didaktike e laboratorike e pasurimi i bibliotekës online
- Përmirësimi I punës kërkimore-shkencore duke rritur edhe bashkpunimin me institucione të tjera Brenda e jashtë vendit.
- Realizimin e pokesit të akreditimit të programit mësimor nga ASCAL.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
Kriteri 3 Programet e studimeve hartohen në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit;	GVJ pasi analizoi misionin dhe qëllimin e institucionit, tës hprehura edhe në rregulloren e universitetit, marrëveshjet dhe objektivate dokumentuara konstaton se Programi Master i Shkencave në "Fizioterapi Klinike" është përgatitur në përputhje me misionin dhe qëllimin, që ka ky Universitet, për formimin cilësor profesional të specialistëve të lartë në fushën e fizioterapisë dhe tërëabilitimit.
Kriteri 4 Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;	Nga takimet me drejtues të Universitetit, stafin pranë universitetit, studentë të programit Bachelor dhe Master në Fizioterapi pyetur mbi kërkesat dhe punësimin e kolegëve të tyre, u informuam që; njohuritë dhe aftësitë e tyre, fituar nga programi i studimit ishin në përputhje me ato çka kërkoheshin në vendet e punës, ku ata punonin, madje jo vetëm në Shqipëri por edhe në vendet e tjera të Europës.
Kriteri 5 Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit;	Kishte studentë që ndiqnin programin e Masterit të cilët ishin punësuar qysh tani në institucione, ku ofrohet shërbimi i fizioterapisë.
Kriteri 6 Programet e studimeve pasqyrojnë vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit.	Sipas drejtuesve të Institucionit, hartimi i këtij programi u nxit nga një nevojë e shoqërisë e shprehur në rritjen e kërkesave për metoda e mjete bashkëkohore menaxhuese, reabilituese e recuperuese, kërkesë kjo e individëve apo edhe e grupeve të caktuara në nevojë për fizioterapi e reabilitim. Duke e parë nga këndvështrimi i traditave kulturore kombëtare në këtë fushë, programi i ofruar nga universiteti, ka një përshtatje dhe mbështetje shkencore e bashkëkohore të traditës krijuar në vendin tonë. Programi, nuk bie ndesh me interesat tona kombëtare, madje i mbështet ato nëpërmjet sigurimit të një cilësie të jetesës më të mirë të individëve apo komunitetit.
Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	
Kriteri 1 Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;	Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe anekseve perkatëse të përcjella nga Institucioni për programin Master i Shkencave Fizioterapi Klinike, e po kështu nga takimet me pedagogët e drejtuesit e Universitetit dhe njohjen e strategjisë së këtij IAL del qartë, përshtatja e këtij programi në përputhje me strategjitë dhe objektivat afatmesme e afatgjata të Universitetit Aldent të paraqitura edhe në RVB
Standardi I.3 - Programet e studimeve ofrohen në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.	

<p>Kriteri 1 Përmbajtja e programeve të studimeve është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 2 Emërtimi i programit të studimit është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit.</p>	<p>Përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p> <p>Emërtimi i programit të studimit “Master i Shkencave” në “Fizioterapi Klinike” është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit. Në hartimin e tij janë marrë parasysh Ligji i Arsimit të Lartë, Udhëzimet e ndryshme të MAS që lidhen me programet e studimit si numri i krediteve (ECTS), tipologjia e lëndëve dhe moduleve, detyrimi i realizimit në fund i temës së diplomës, formati I diplomës e suplementi, etj.</p>
<p>Standardi I.11 - Institucioni harton një plan zhvillimi të programeve të studimeve, të rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</p>	<p>Referuar dokumentit të Strategjisë së UAL 2016-2020, ky institucion ka një plan strategjik për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimeve dhe për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</p> <p>Ky Plan gjendet i mbështetur mbi objektiva profesionale, në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe synimin për zhvillimin e këtij profesioni. Në strategjinë e institucionit janë të përcaktuara objektivat për stafin, infrastrukturën dhe studentët duke patur në fokus kryesor përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <p>Programi i studimeve është hartuar në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit; me nevojat e tregut të punës; me zhvillimin ekonomik e kulturor të vendit; me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi; dhe mbi bazen e një strategjie të studuar e të përditësuar garantuese të cilesisë së mësimdhënies e të nxënit.</p> <p><u>Ky Standard plotësohet</u></p>	

Rubrika 2 - Struktura akademike e Fakultetit (përgjegjës për programin e studimit)

Pjesa përshkrimore

Terma reference: përbërësit e njësisë dhe stafet e tyre, kompetencat, Baza e të dhënave të njësisë, freskimi i vazhdueshëm i saj dhe përgjegjësitë e mbajtjes dhe dhënies së informacionit

Në zbatim të dispozitave të Ligjit Nr 80/2015 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Statutin e universitetit “ALDENT” është përcaktuar struktura organizative e institucionit. Njësitë përbërëse, funksionet e kompetencat e çdo njësi, lidhjet e varësitë që kanë ndërmjet tyre.

Universiteti Aldent e organizon aktivitetin akademik mbështetur në Urdhërin e Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës Nr. 115, datë 13.03.2017 duke u organizuar në tre fakultete si më poshtë:

a. Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike

b. Fakulteti i Shkencave Mjekësore

c. Fakulteti i Shkencave Dentare

Njësia kryesore (Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike)

Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike ka në përbërje departamentet si më poshtë:

- Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë
- Departamenti Laborant Mjekësor dhe Imazheri
- Qendra e Promovimit të Shëndetit

- *Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe me kontratë (PAK) sipas RVB gjëndet në Aneksë, Tabela 1:*

Struktura e Fakultetit, përbërja e tij, si funksionon, çfarë detyrash mbulon, janë të përcaktuara në Rregulloren e tij. Në rregulloren e brendëshme të Fakultetit evidentohen qartë edhe mënyrat e organizimit, modalitetet e funksionimit të veprimtarive pedagogjike, rregullat administrative dhe studentore, mekanizmat vendimmarrëse në linjën vertikale dhe horizontale, si dhe sigurimi i standardeve të cilësisë së brendëshme dhe kërkimit shkencor.

Dekani është autoriteti më i lartë drejtues i Fakultetit dhe emërohet në detyrë nga Rektori me pëlqimin e administratorit të UAL, për një periudhë 4-vjecare me të drejtë rizgjedhje. Marrëdhëniet ndërmjet personit juridik dhe dekanit përcaktohen në kontratën e punës.

Dekani aktualisht ka gradën “Doktor” në kundërshtim me LAL 80/2015 neni 42 pika 3, ku përcaktohet që Dekani duhet të jetë personel akademik i kategorisë “Profesor”.

Gjatë takimit të GVJ me Dekanin e Fakultetit, GVJ ju prezantua detyrat që mbulonte Dekania si:

- Drejtimi I të gjithë punës mësimore e shkencore në Fakultet;
- Miratimi I Rregullores së brendëshme të njësive në përbërje të Fakultetit;
- Miratimi I anëtarëve dhe kryetarëve të komisioneve të provimeve të pranimit, të provimeve të formimit dhe të mbrojtjes së diplomave;
- Miratimi I tezave të provimeve të pranimit, të provimeve të formimit dhe temat e projekt diplomave;
- Vendos gjithashtu përjashtimin nga Universiteti “ALDENT” të studentëve për rastet e parashikuara në rregulloren e fakultetit;
- Dekania I paraqet Rektorit çdo vit raportin për aktivitetin mësimor, shkencor dhe financiar të fakultetit
- Organizimi I vlerësimit të brendshëm në Fakultet.

Përcaktimi i hollësishëm i detyrave të Dekanit, pasqyrohej në Rregulloren e Fakultetit.

Departamenti Infermieri dhe Fizioterapi aktualisht ofron dy programe të ciklit të parë Bachelor në “Infermieri të përgjithëshme”, Bsc në “Fizioterapi” dhe një program të ciklit të dytë Master I Shkencave në “Fizioterapi Klinike”. Gjatë vizitës së GVB në Institucion mungonte Përgjegjësja e Departamentit për arsye shëndetësore dhe një pasqyrim të punës dhe aktivitetit të këtij Departamenti, e prezantoi Dekania e Fakultetit Dr Nedime Ceka dhe Dekani I Fakultetit të Shkencave Mjekësore Prof Ass Agim Shehi. Profesor Shehi mori pjesë në këtë takim, për arsye të memories institucionale që kishte për programet në fushën e fizioterapisë, të cilat para riorganizimit të këtij Institucioni kanë qënë pjesë e Fakultetit të Shkencave

Mjekësore, Dekan I të cilës është Prof Ass Agim Shehi. Vlen të theksohet që Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë e paraqet si staf të tijin Prof. As Agim Shehi, I cili aktualisht është Dekan i Fakultetit të Shkencave Mjekësore

Disa nga kompetencat e Departamentit, po I rradhisim si më poshtë:

- Shqyrtimi I planeve mësimore duke ja paraqitur për miratim Dekanatit të Fakultetit i cili I përcjell tek Senati I Universitetit.
- Shqyrtimi I programeve mësimore
- Përcaktimi I tematikës së studimit dhe të kërkimit shkencor
- Vetëvlerësimi I veprimtarisë mësimore shkencore

Në fund të çdo viti akademik, departamentet planifikonin sipas nevojave kërkesës për staf për vitin akademik në vijim.

Stafi I Departamentit përbëhej nga:

- Personel Akademik me kohë të plotë 10 (dhjetë) gjithsej nga të cilët: 3 Prof. As; 7 Msc
- Personel Akademik me kohë të pjesshme 8 (tetë) gjithsej nga të cilët 1 Prof. As; 2 Dr, 1 SPA, 4 Msc
- *Të dhënat për Departamentin e Infermierisë dhe Fizioterapisë për vitin 2017-2018 gjenden në Aneksë, Tabela 2*
- *Të dhënat për Departamentin Laborant Mjekësor dhe Imazheri për vitin 2017-2018 të marra gjatë vizitës në vend gjenden në Aneksë, Tabela 3*
- *Të dhënat për Qendrën e Promovimit të Shëndetit për vitin 2017-2018 të marra gjatë vizitës në vend, gjenden në Aneksë, Tabela 4*

Njësitë ndihmëse si: Laboratorët, njësitë didaktike, biblioteka dhe njësi të tjera, realizonin studime, projektme dhe ofronin shërbime të ndryshme në funksion të programit.

Këto Njësi përmbanin materiale didaktike, mjete mësimore, aparatura të posaçme dhe luanin një rol të rëndësishëm për zhvillimin e një pjese të mirë të lëndëve/moduleve profesionale rehabilituese.

Vlerësimi sipas standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.2 - Institucioni organizohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për përmbushjen e misionit të tij.	
Kriteri 1 Institucioni organizohet në mënyrë që të përmbushë misionin e tij;	Gjatë vizitës në Institucion por edhe gjatë shqyrtimit të RVB, GVJ konstaton se Universiteti Aldent e organizon aktivitetin akademik mbështetur në Urdhërin e Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës Nr. 115, datë 13.03.2017 duke u organizuar në tre fakultete si më poshtë: a. Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike b. Fakulteti i Shkencave Mjekësore c. Fakulteti i Shkencave Dentare Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike është organizuar si më poshtë: • Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë
Kriteri 2 Institucioni ka së paku dy Fakultete;	
Kriteri 3 Fakulteti organizohet në njësi bazë. Çdo fakultet ka, së paku, tri të tilla, nga të cilat dy departamente;	
Kriteri 4 Fakulteti ose Instituti i Kërkimit dhe Zhvillimit përbëhet nga, së paku, 3 njësi bazë me objektiva dhe mision të mirëpërcaktuar;	
Kriteri 5 Departamenti duhet të ketë në përbërje të tij të paktën 7 anëtarë efektivë si personel	

<p>akademik, ndër të cilët të paktën 3 duhet të jenë me gradën shkencore “Doktor”.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Departamenti Laborant Mjekësor dhe Imazheri • Qendra e Promovimit të Shëndetit <p>Në Departamentin përgjegjës për këtë program studimi, Departamenti I Infermierisë dhe Fizioterapisë aktualisht janë pjesë përbërëse e tij 10 personel akademik më kohë të plotë nga të cilët 3 Prof Ass dhe 7 Msc</p>
--	--

Standardi II.3 - Njësitë e institucionit angazhohen drejtpërdrejt dhe me përkushtim për realizimin e programeve të studimeve.

<p>Kriteri 1 Njësitë bazë dhe kryesore janë të ndërgjegjshme për përgjegjësitë që kanë për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Njësitë bazë dhe kryesore përfshihen në procesin e rekrutimit të personelit akademik të nevojshëm dhe në vlerësimin e tij.</p>	<p>Gjatë takimeve që realizoi GVJ, Drejtuesit e këtij Institucioni theksuan se Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike dhe Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë janë të ndërgjegjshëm për përgjegjësitë e tyre për realizimin sa më cilësor të programit të studimit. Kjo përgjegjësi dukej në hartimin e programit të studimit konform akteve ligjore dhe nënligjore.</p> <p>Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike përpiqej që të rekrutonte staf mësimdhënës me kohë të plotë dhe me kohë të pjeshme me tituj dhe me grada, por u evidentua nga ta vështirësia në rekrutimin e këtij stafi për arsye të mungesës së pedagogëve me tituj kryesisht në fushën e fizioterapisë në nivel kombëtar. Gjatë takimit me Drejtuesin e Fakultetit na u komunikua se Dekanati në bashkëpunim me departamentin përcaktojnë kriteret specifike për pozicionin e punës duke vlerësuar përgatitjen profesionale dhe ngritjen akademike të kandidatave. Gjatë procesit të rekrutimit komisioni i ngritur në nivel fakulteti merr në shqyrtim kandidaturat dhe nëpërmjet një sistemi të pikëzimit shpall fituesin duke ia paraqitur propozimin rektorit të Universitetit. Ka pra një procedure të përcaktuar për çdo hap në drejtim të rekrutimit të stafit akademik.</p>
--	---

Konkluzionet e vlerësimit:

1-Institucioni është I organizuar në mënyrë të tillë që të përmbushë misionin e tij. Përbëhet nga 3 Fakultete. Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, përgjegjëse për këtë program studimi, së bashku me Departamentet e tij, funksionojnë në përputhje me ligjin e arsimit të lartë 80/2015 dhe akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

2- Ligji nr. 80/2015 për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë, neni 42 pika 3 përcakton që Dekani duhet të jetë personel akademik i kategorisë “Profesor”, çka për momentin nuk përputhet me gradën shkencore “Doktor” të Dekanit aktual të Fakultetit Shkencave Mjekësore Teknike në UAL. Rekomandojmë që në të ardhmen të rregullohet përputhshmëria e titullit dhe gradës me detyrën si drejtues i njësisë kryesore. Ky është një detyrim ligjor që duhet zbatuar,

pavarsisht nga angazhimi, eksperiencia në punë dhe në vite dhe kompetenca e lartë dhe cilësore e Drejtueses së këtij Fakulteti.

Standardet plotësohen kryesisht

Rubrika 3 - Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Të dhëna për kualifikimin e Personelit akademik, ndarja e tij në Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personel Administrativ (PA), raporti PAE/PAK, raportet: Personel akademik/Personel administrativ/student; nevojat për Personel akademik/ administrativ, shpërndarja e ngarkesës për personelin akademik, marrëdhëniet me strukturat e tjera jashtë kohës së punësimit, kriteret e rekrutimit të personelit akademik, etj.

Sipas drejtuesve të Institucionit, Universiteti Aldent ka synuar gjithmonë të rekrutojë staf të kualifikuar me përvojë akademike dhe profesionale. Në programin e Fizioterapisë Klinike është synuar gjatë këtyre dy viteve që ofrohet ky program, rritja e stafit akademik efektiv. Kjo domosdoshmëri ka lindur si rrjedhojë e rritjes së numrit të studentave. Gjithashtu ka lindur edhe si detyrim për të rritur cilësinë dhe standardet e mësimdhënies. Për këtë program, ishin ofruar kandidatë që kanë përvojë në fushën pedagogjike si dhe përvojë në ushtrimin praktik të profesionit. Përveç pedagogëve me tituj e grada, për lëndet e karakterit të përgjithshëm formues, në Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike janë punësuar edhe pedagogë me Master shkencor apo Specializime Afatgjatë, por që kanë një eksperiencë specifike e të suksesshme në profesionin e fizioterapeutit. Disa prej këtyre pedagogëve kanë mbaruar studimet ose janë specializuar jashtë vendit. Materiali mbi ngarkesën e stafit efektiv u kerkua nga GVJ gjatë vizitës në UA për të dy programet edhe Bsc edhe Msc në Fizioterapi. Ngarkesa e stafit akademik të angazhuar në këto programe ndodhet në system. Disa nga pedagogët me kohë të plotë të angazhuar në mësimdhënien e programit Msc për vitin akademik 2017-2018 rezultojnë në total me një numër të madh lëndësh që variojnë nga 9 lëndë deri në 1 lëndë. Ngarkesa në orë në totalin vjetor për PAE paraqitet nga 392.6 orë deri në 115.5 orë

Për vitin akademik 2016-2017, në programin e Fizioterapisë Klinike raporti pedagog /student ishte: 40/17 = 2.3 studentë për një pedagog.

Për vitin akademik 2017-2018, në programin e Fizioterapisë Klinike raporti pedagog /student ishte: 78/25 = 3.4 studentë për një pedagog.

Në rekrutimin e stafit akademik zbatohet praktika sipas kriterëve të rekrutimit, të miratuara në Senatën akademik sipas një sistemi pikëzimi të arsimit, kualifikimit në fushën përkatëse, përvojës akademike dhe titullit në fushën e fizioterapisë. Departamenti përfshihet në procesin e rekrutimit të stafit akademik i cili bëhet në disa faza si më poshtë: Parashtrohet kërkesa në përputhje me vendet e lira si dhe me ngarkesën mësimore duke hartuar kriteret specifike për këto vende. Dekanati pasi merr me shkrim kriteret nga departamenti i kërkon Rektorit aprovimin për fillimin e procesit. Burimet njerëzore në faqen zyrtare të Institucionit shpallnin vendin vakant dhe merrnin në dorëzim dosjet e aplikantëve; ngrihet komisioni përkatës me 4-5 veta ku të paktën 3 veta duhet të jenë anëtarë të Departamentit i cili shqyrton dosjet sipas një sistemi pikëzimi të miratuar më parë. Kandidatët klasifikohen sipas pikëve të fituara.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- *Numri i Personelit Akademik me kohë të plote (PAE) dhe Personelit Akademik me kohë të pjesshme (PAK), titujt/gradat per vitet akademike 2016-2017 dhe 2017-2018 gjenden në anekse, Tabela 5 per vitin akademik 2017-2018 dhe Tabela 6 per vitin akademik 2016-2017*

GVJ konstaton se në vitin akademik 2017-2018, në këtë program studimi angazhohet staf akademik me kohë të plotë me një përmirësim në cilësi të titujve dhe gradave. Në vitin akademik 2016-2017 programi I studimit ofrohej nga pedagogë të ciltë ishin vetëm me Msc. Në vitin aktual, 2017-2018 numri I stafit me kohë të plotë është rritur si nga ana numerike (ishin 7 PAE në vitin 2016-2017 dhe aktualisht janë 14 PAE) por edhe në tituj dhe grada (nga 7 pedagogë MSC në 14 Pedagogënga të cilët 2 Prof. As, 3 Dr, 1 SPA dhe 8 Msc)

- *Këshilli Shkencor i Programit të studimit dhe Koordinator/ët e programit të studimit gjenden në Aneke, Tabela 7*
- *Të dhënat sipas seksit gjenden në Aneke, Tabela 8*
- *Të dhënat sipas moshës të paraqitura në RVB për vitin akademik 2017-2018 për stafin me kohë të plotë (lexo PAE) dhe stafin administrative në programin e studimit gjenden në Aneke, Tabela 9*
- *Të dhënat sipas moshës të paraqitura në RVB për vitin akademik 2017-2018 për stafin me kohë të pjesshme (lexo PAK) në programin e studimit gjenden në anekse, tabela 10*
- *Të dhënat për personelin me kohë të plotë dhe personelin administrative të të gjithë Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike sipas Departamenteve përbërës së tij, të marra gjatë vizitës në Institucion, gjenden në anekse, tabela 11*

Referuar të dhënave të marra gjatë vizitës në zyrën e burimeve njerëzore, GVJ konstaton se në Departamentin e Infermierisë dhe fizioterapisë si dhe në Departamentin Lab mjeksor dhe imazherisë ka personel akademik me kohë të plotë që është mbi grup moshën 60-68 vjeç (konkretisht 1(një) në Departamentin e Infermierisë dhe fizioterapisë dhe 1 (një) në Departamentin Laborant mjeksor dhe Imazheri. Ndërsa për Qendrën e promovimit të shëndetit nuk mund të japim të dhëna të sakta pasi mungon mosha për shumicën përbërëse të pedagogëve të kësaj Qendre.

√ - Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat

Nga zyra e burimeve njerëzore na u sqarua se si lidhej kontrata e punës me personelin akademik por edhe atë administrative, sipas nevojave që kishte Institucioni, Pas procesit të rekrutimit, personeli akademik e administrativ lidhte kontratë pune me Universitetin "Aldent" hartuar kjo në bazë të ligjit të "Kodit të Punës", "Kodit Civil", Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë si dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore, të cilat përshkruhen edhe në rregulloret dhe Statutin e Institucionit.

Kontratat e punës në Universitetin Aldent janë ndarë në tre lloje: staf akademik me kohë të plotë, staf akademik me kohë të pjesshme dhe staf administrative dhe ndihmës. Ato janë miratuar nga Senati dhe përmbajnë përshkrimin e punës, pagën si dhe të drejtat dhe detyrimet që lindin prej saj. Me njëpërzgjedhje rastësore, GVJ kontrollon tre kontrata pune (2 për personal me kohë të plotë dhe 1 për personel me kohë të pjesshme). Kontratat e punës për personelin me kohë të plotë ishin lidhur me afat të pacaktuar, ndërsa për personelin me kohë të pjesshme, kontrata ishte lidhur me afat 1 –vjeçar.

√ - Cilësia e stafit ndihmës/ administrativ për çdo njësi bazë

U konstatua një angazhim I kënaqshëm i personelit akademik dhe atij ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve teorike, laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve ku beheshin leksionet, praktikat e në vecanti për Mjediset e Fizioterapisë.

√ - Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

U kërkuan dhe na u dhanë dokumenta nga zyra e burimeve njerëzore (dosje personale e personelit akademik, kontratat e punës). Lista të personelit për programet PAE dhe PAK, sipas titujve, moshës e seksit, formularin e vlerësimit të performances personelit, etj.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.1 - Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ angazhohen për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve.	
Kriteri 1 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me objektivat e programeve të studimeve dhe për arritjen e tyre; Kriteri 2 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	GVJ gjatë vizitës në zyrën e burimeve njerëzore por edhe gjatë vizitës në ambientet e UAL ku zhvillohej mësim, konstatoi një angazhim të kënaqshëm të personelit akademik, administrativ dhe atij ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve teorike, laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve ku bëheshin leksionet, praktikat lëndore e në vecanti për Mjediset dhe laboratorët në funksion të programit të Fizioterapisë.
Standardi II.4 - Personeli akademik angazhohet në hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të institucionit.	
Kriteri 1 Personeli akademik luan rol kryesor në hartimin e kurrikulës dhe në vendimet institucionale që i përkasin organizimit të programeve të studimeve; Kriteri 2 Rekrutimi i personelit të ri dhe përcaktimi i ngarkesës mësimore bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.	GVJ gjatë takimit me personelin akademik të angazhuar në këtë program studimi, konstatoi se personeli akademik luan rol kryesor në hartimin e kurrikulës dhe në vendimet institucionale që i përkasin organizimit të programeve të studimeve. Titullarët e lëndëve përgatisin syllabuset për çdo lëndë. Ato përmbajnë të gjithë elementet e duhura si nga përmbajtja (tematika) edhe objektivat, mënyrën e realizimit dhe vlersimin e studentëve, literaturën etj. Vërejmë se disa titullarë të lëndëve nuk janë personel akademik me kohë të plotë pranë këtij Institucioni. Çdo vendim institucional për përmirësime apo ndryshime në kurrikula, merrej duke u bazuar në propozimet e bëra nga njësitë bazë. Institucioni ka përcaktuar qartësisht kriteret dhe procedurën për përzgjedhjen e stafit akademik. Rekrutimi i personelit në UAL bëhet në bazë të kriterëve të përgjithshme të hartuara nga Dekanati dhe ato specifike të hartuara nga Departamenti.

	Edhe ngarkesa mësimore hartohet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.
Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve respektive të studimeve;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për vende vakante, etj.</p>	<p>Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, për të plotësuar nevojat e programeve të studimit për staf akademik, ndihmës shkencor dhe administrativ ndjek politikën e punësimit dhe të rekrutimit të stafit me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme sipas nevojës. Ka procedurë të caktuar për punësimin e personelit akademik që kalon në disa hallka si statuti, rregulloret etj.</p> <p>PAE është i angazhuar në realizimin e programit në masën 76% në përputhje me standardin e kërkuar.</p> <p>Senati akademik ka miratuar edhe formularin për vlerësimin e performancës së personelit akademik me qëllim identifikimin e mangësive dhe përmirësimin e tyre</p> <p>Vlerësimi është mbështetur në faktorë si mësimdhënia, dhënia e asistencës dhe konsultimeve me studentët, kërkimi shkencor, pjesëmarrja në seminare, konferenca, kongrese workshope, botimet shkencore, respektimi i konfidencialitetit në lidhje me aktet e institucionit, shfrytëzimi me efikasitetin e kohës së punës, veprimtari mbështetëse për institucionin gjatë vitit akademik.</p> <p>Transparenca sigurohet nëpërmjet web-it të UAL.</p> <p>Fakulteti në bashkëpunim me zyrën e Burimeve Njerëzore mban rekordet e procesit të rekrutimit dhe të të dhënave të kandidatëve aplikues si dhe shpalljen e fituesve dhe ka krijuar një bazë të dhënash në vite.</p>
Standardi III.2 - Personeli akademik (me grada shkencore dhe tituj akademikë) mbulon nevojat e institucionit dhe i ka të përcaktuara qartë përgjegjësitë.	
<p>Kriteri 1 Përgjegjësi i programit ka të paktën titullin “Profesor i asociuar” ose, gradën shkencore “Doktor” (“PHD”) të fituar pranë universiteteve perëndimore dhe përvojë akademike në këto universitete;</p> <p>Kriteri 2 Titullari i lëndës/modulit në programet e studimeve “Master i Shkencave” ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p> <p>Kriteri 3 Titullari dhe pedagogët e lëndës/modulit në programet e studimeve “Master profesional” ka të paktën gradën shkencore “Doktor” ose, diplomën “Master Profesional” ose “Master Shkencash” dhe një përvojë profesionale së paku 5-vjeçare në</p>	<p>Përgjegjësi I Programit ka titullin “Prof.As” dhe përvojë akademike në universitet;</p> <p>Pedagogët e përzgjedhur përfaqësonin nivel të lartë profesional, akademik e shkencor në fushën e fizioterapisë e rehabilitimit. Si titullarë të programit ishin përzgjedhur ata me përvojë, grada shkencore e tituj akademikë Prof. As, Doktor e Kërkues.</p> <p>Kjo pikë nuk i përket programit që vlerësohet.</p> <p>Drejtuesi I Njesisë Kryesore por edhe drejtuesit e njësive bazë të Fakultetit ku ofrohëj ky program studimi</p>

<p>profesionin në të cilin ofrohet ky program studimi;</p> <p>Kriteri 4Rektori, zv/rektori, drejtori dhe zv/drejtori i qendrës ndëruniversitare, dekani, zv/dekani, drejtori, përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i shërbimit, përgjegjësi i programit janë të punësuar me kohë të plotë në institucionin që ofron programin e studimeve;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni siguron personel të mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale.</p>	<p>punësuar me kohë të plotë, cka parashikohet edhe në Statutin e Universitetit.</p> <p>Gjatë takimit me studentët, GVJ konstatoi se Institucioni kishte krijuar mundësinë dhe siguronte personel të mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale duke iu ofruar studentëve gjithcka ata kishin nevojë.</p>
<p>Standardi III.5 - Studentët që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave” apo programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë kanë udhëheqës për tezën.</p>	
<p>Kriteri 1 Studentët që ndjekin këto programe studimesh kanë një udhëheqës për punën kërkimore dhe tezën që përgatisin për marrjen e diplomës në përfundim të studimeve të këtij cikli;</p> <p>Kriteri 2 Udhëheqësi ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p> <p>Kriteri 3 Udhëheqësi nuk mbikëqyr më shumë se 5 (pesë) studentë njëkohësisht për temat me karakter kërkimor të aplikuar (si ato të ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave të natyrës, shkencave mjekësore, etj.) dhe më shumë se 10 (dhjetë) studentë njëkohësisht për temat e ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave shoqërore e humane.</p>	<p>Gjatë takimit me studentët por edhe me stafin akademik, GVJ konstatoi se për studentët që ndjekin Programin Master i Shkencave është parashikuar të ketë një udhëheqës për punën kërkimore dhe tezën që përgatisin për marrjen e diplomës në përfundim të studimeve të këtij cikli.</p> <p>Udhëheqësit e tezës diplomës janë pedagogë titullarë, që kanë gradën Doktor. Gjithashtu për studentët që ndjekin Programin Master i Shkencave është parashikuar që udhëheqësi të ketë maksimum 5 studentë njëkohësisht,</p>
<p>Standardi III.6 - Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit dhe është parashikuar të përgatitet teza.</p>	
<p>Kriteri 1 Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit.</p> <p>Kriteri 2 Udhëheqësi ka njohuri të avancuara teorike dhe aftësi të veçanta kërkimore në fushën në të cilën ofrohet programi i studimeve dhe në të cilën është parashikuar të hartohet teza.</p>	<p>Gjate takimit me stafin akademik por edhe me drejtuesit, GVJ ju komunikua se fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi për ndjekjen e tezës, është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit’ Ky Udhëheqës është një nga titullarët e lëndëve të ofruara në këtë program.</p>
<p>Standardi III.7 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon një përdorim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>U konstatua një angazhim optimal i personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore, në veçanti për mjediset e Fizioterapisë, për kabinetet e aparaturat reabilituese të përdorura për këtë program. GVJ gjatë vizitës në labororet në funksion të këtij programi vuri re një investim të këtij Institucioni në blerjen e pajisjeve për njëmbarrëvajtje sa më të mirë të Programit Master.</p>
<p>Standardi III.8 - Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	

Kriteri 1 Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi;

Kriteri 2 Ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë dhe organizimi e drejtimi i tyre, vlerësohen me orë mësimore.

GVJ ju komunikua se drejtuesi i njësisë bazë në koordinim me secilin pjestar të stafit në çdo fillim viti akademik përcakton ngarkesën mësimore të secilit. Ngarkesa mësimore brenda auditorit vlerësohej në orë mësimore. Ngarkesa e antareve të stafit është e tillë që ti lejojë ata të merren edhe me punë të tjera në ndihmë të institucionit apo me punë kërkimore-shkencore. Kjo u pohua edhe gjatë takimit të GVJ me stafin e këtij programi

Standardi III.9 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.

Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;

Kriteri 2 Institucioni disponon për secilin semestër listën e plotë të personelit akademik, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrativ;

Kriteri 3 Institucioni përcakton dhe publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik.

GVJ gjatë vizitës në Burimet njerëzore konstatoi se të dhënat për personelin janë të arkivuara pranë kësaj zyre dhe përditësohen gjatë vitit akademik. Institucioni disponon listën e plotë të personelit akademik, ndihmës shkencor dhe administrativ, si dhe dokumentacionin e nevojshëm të çdo punonjësi. Sipas drejtueses së kësaj zyre, të dhënat e personelit hidheshin dhe ruheshin në sistemin informatik FX që është instaluar për burimet njerëzore pranë institucionit. Në çdo departament janë të përcaktuara kriteret e rekrutimit të personelit sipas nevojave të institucionit dhe ato parashtrihen në përputhje me ngarkesën mësimore specifike për vendet vakante. Senati ka të përcaktuar një procedurë për rekrutimin e stafit akademik.

Konkluzionet e vlerësimit:

Struktura didaktike për departamentet ose programin e studimit është optimale e sipas standardeve. Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe Personelit Akademik me Kontratë (PAK), titujt/gradat, plotësojnë nevojat e realizimit të programit Cilësia e stafit drejtues, mësimdhënës dhe administrativ për programin e studimit është në përputhje me kërkesat e e vendosuar nga Institucioni. Si staf mësimdhënës paraqiten edhe lektorë me titull Msc, që kanë përvojë dhe eksperiencë disa vjeçare dhe shumica e tyre kanë mbaruar studimet Master në vendet e BE-së, gjë që nuk e çënon realizimin me cilësi të programit të studimit, por shihet si një potencial I gatshëm për studimet e thelluara në Doktoraturë sapo MASR të nxjerrë kuota për vijimësinë e studimeve, duke u mbështetur financiarisht edhe nga Universiteti Aldent qoftë edhe në vendet e BE-së ku ato kanë kryer studimet Msc. Realiteti është që në tregun shqiptar mungojnë pedagogë me titull dhe grada pasi programi I Fizioterapisë është mesatarisht program I ri.

Tashmë është krijuar një bazë të dhënash elektronike të dokumentacionit për çdo pjestar të stafit akademik, si CV, aktivitet shkencor, kualifikime etj.

Standardet plotësohen

Rubrika 4 -- Infrastruktura në funksion të programit të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: mjediset, infrastruktura, teknologjia e informacionit, biblioteka, shërbime të tjera për studentët, residencat.

Mbështetur në të dhënat e deklaruara në RVB, Universiteti Aldent ka në përdorim të tij një sipërfaqe rreth 8600 m². Godinat egzistuese përfaqësojnë një tërësi hapësirash me funksione të përcaktuara në shërbim të procesit mësimor apo shërbimeve të lidhura me të. Gjatë vizitës në ambjentet ku zhvillohet programi Msc në Fizioterapi Klinike, GVJ konstaton se mjediset mësimore janë me madhësi e me kapacitet të ndryshëm në përshtatje me natyrën e procesit mësimor. Për studentët e Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike janë në dispozicion rreth 5000 m², në të cilën përfshihen salla leksionesh dhe seminaresh me kapacitet nga 30 deri në 120 studentë, laboratorë me pajisjet e nevojshme, zyra për stafin dhe qeverinë studentore, bibliotekë, kafeteri, parking, etj.

Gjatë vizitës së GVJ në këtë Institucion u konstatua se:

Auditorët mësimorë- Të gjitha sallat e leksioneve dhe seminareve janë të pajisura me video-projektor, kompjuter të lidhur me internet dhe tabela. Klasat janë të mobiluara me karrige të bashkëlidhura me tavoleta. Dritaret janë të pajisura me grila ose perde nga brenda për të krijuar mundësinë e projeksionit gjatë zhvillimit të mësimi. Ndriçimi natyral dhe ai artificial janë të bollshme.

Ambientet për personelin pedagogjik dhe administrative- Në dispozicion të personelit akademik dhe administrativ ka ambiente të mjaftueshme e komode për punë dhe studimi individual të pajisura me mjetet e nevojshme logjistike.

Ambientet për bibliotekë, salla audiovizive, teknologjia etj. - Për bibliotekën dhe teknologjinë janë vënë në dispozicion dy salla me kapacitet rreth 60 poste leximi, 15 poste interneti të pajisura me kompjuter dhe biblioteka që kanë rreth 13500 tituj librash profesionalë. UAL ka një rrjet kompjuterik të shpërndarë në të gjithë godinën i cili u vjen në ndihmë stafit dhe studentëve.

Sallat e leksioneve dhe seminareve janë të pajisura me kompjutera dhe projektorë gjithashtu u jepet dhe akses në internet nëse është e nevojshme. Çdo zyrë është e paisur me kompjuter, akses në internet. I gjithë stafi i ALDENT ka adresën e brendëshme të email (.....@ual.edu.al) të cilën mund ta aksesojë si brenda dhe jashtë universitetit. Të gjithë studentet e ALDENT kanë adresat e brendëshme të email, të cilat mund ti aksesojnë nëpërmjet rrjetit ëireless në të gjithë godinën ose nga çdo vend tjetër rreth godinës UAL. Me qëllim lehtësimin e aksesit në të dhënat personale, rezultateve të provimeve, vitin akademik si dhe informacione të tjera didaktike në dispozicion të studentëve, është instaluar portali i studentit, i aksesueshëm në kohë reale nëpërmjet ëeb faqes ual.edu.al nga studentët në çdo paisje pc dhe mobile të lidhur me internetin. ...@ualstudent.info

Sipas punonjësës së Bibliotekës, Aldent është i abonuar prej disa vitesh në bibliotekën Hinari, bibliotekë e Organizatës Botërore të Shëndetësisë e cila shfrytëzohet aktivisht nga stafi dhe studentët.

Sistemi i ngrohje-ftohjes - Objektet janë të pajisura me sistemin e ngrohje-ftohjes qendrore të konceptuara nga ndërtuesit që në projektim për kapacitet e shkollës.

Sistemi i sigurimit pa ndërprerje të energjisë elektrike - Ambientet e Universitetit Aldent janë pajisur me gjenerator dhe invertera për sistemin kompjuterik duke siguruar energji elektrike pa ndërprerje.

Nyjat hidrosanitare. - Shkolla disponon mbi 60 nyje hidrosanitare të kompletuara më së miri me standarde të larta higjiëno –sanitare.

Sistemi i mbrojtjes kundra zjarrit. - Godinat kanë të instaluar sistemin kundra zjarrit. Ato plotësojnë kushtet teknike të parashikuara me ligj për mbrojtjen nga zjarri.

Sistemi i sigurisë dhe vëzhgimit të ambienteve. - Ambientet mësimore janë të pajisura të gjitha me kamera që monitorojnë 24 orë në 24 për të cilat janë vënë në dijeni si studentët ashtu edhe stafi akademik. Laboratorët në shërbim të studentëve që ndjekin programin e studimit Msc. në fizioterapi janë:

Laboratorët e Anatomisë dhe Fiziologjisë- Atelie i pajisur me manikine dhe mulazhe të përshtatshme për t'u zhvilluar dhe kuptuar sa më mirë Anatomia humane dhe Fiziologjia si lëndë bazë të profesioneve mjekësore

Laboratorët e Histologjisë dhe Anatomisë patologjike- Kabinete të pajisura me mikroskopë dhe apartura të tjera të dedikuara për të zhvilluar lëndët e Histologjisë dhe Anatomisë patologjike. Pedagogët e kualifikuar u demonstronë në preparate të parapërgatitura inde të ndryshme në mënyrë që studentët të arrijnë të diferencojnë dhe të kuptojnë karakteristikat e tyre në gjendje normale dhe patologjike.

Laboratorët e FIZIOTERAPISË- Janë 3(tre)laboratorë kryesorë që shërbejnë për të kryer orët laboratorike të lëndëve rehabilituese si një domosdoshmëri për studentët e programit të Fizioterapisë të të gjitha viteve. Para se të fillojnë praktikat spitalore pranë shtrimit të pacientit synohet që studentët të praktikojnë të gjitha metodat rehabilitues në manekinët e dedikuara për këto procese dhe ndaj njëri- tjetrit në grupe të vogla. Në këto atelie gjenden. gjitha paisjet e nevojshme për procedura të rehabilitimit që kryhen në pacientët realë, të tilla si shtretër profesional për manipulime fizioterapeutike, aparate me ultratinguj dhe infrared, ketler, bicikleta dhe pista vrapimi, step si dhe një sërë mjedesh të tjera ndihmese për rehabilitim fizioterapeutik.

Laboratorët e informatikës- Auditore të pajisur me 50 kompjutera në total të ndarë në tre klasa, të lidhur me internetin ku zhvillohet lënda e Informatikës gjatë së cilës studentët marrin njohuri efektive mbi përdorimin e programeve bazë kompjuterike. Të gjitha sallat e laboratoreve dhe leksioneve janë me ndriçim të mjaftueshëm natyral dhe artificial, me dritare me dopio xham si dhe me ajër të kondicionuar.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të dhënat për mjediset në funksion të programit të studimit gjenden në Aneksë, Tabela 12
- Të dhënat për mjediset për stafin në funksion të programeve të studimit të ofruara nga Fakulteti I Shkencave Mjekësore teknike, gjenden në Aneksë, Tabela 13

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.5 - Institucioni siguron infrastrukturën e nevojshme për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë që ofron.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ka një vendndodhje të përhershme, që nënkupton mjedis qendror administrativ dhe mjedis ku zhvillohet veprimtaria mësimore;</p> <p>Kriteri 2 Këto mjedise janë në dispozicion të institucionit për jo më pak se 6 vjet;</p> <p>Kriteri 3 Nëse programi i studimit ofrohet në më shumë se një godinë, institucioni siguron menaxhim efikas dhe kontroll të vazhdueshëm për arritjen e standardeve dhe zbatimin e politikave arsimore të hartuara për realizimin e programeve të studimeve që ofron;</p>	<p>Universiteti "Aldent" prej shumë vitesh është pozicionuar si fillim në një ambient jo shumë larg prej qendrës së Tiranës. Po prej disa vitesh, me rritjen e programeve të studimit dhe të studentëve që frekuentojnë ato, UAL ka në përdorim edhe një Kampus me adresë: Autostrada Tiranë –Durrës, km1.</p> <p>Programi i studimit Master i Shkencave në Fizioterapi Klinike e zhvillon procesin mësimor në Kampusin UAL me adresë: Autostrada Tiranë –Durrës, km 1. Për të lehtësuar lëvizjen e studentëve për në kampus universiteti ofron transport falas nga Qendra e Tiranës deri në institucion dhe kthim. Në rastet kur studentët vijnë me makinat e tyre ofron parking falas.</p>

<p>Kriteri 4 Institucioni garanton kapacitete dhe mjedise të mjaftueshme për realizimin e praktikave profesionale të parashikuara për realizimin e programeve të studimeve në fushat e shëndetësisë, veterinarisë, bujqësisë, shkencave teknike, etj.</p>	<p>Godina ku zhvillohet mësimi është një godinë relativisht e re, me sipërfaqe të bollshme, me laboratorë për praktikën mësimore të pajisur me materiale dhe pajisje për këtë program studim, si dhe me një palestër të mirëpajisur.</p> <p>Labororet e Universitetit ishin të pajisura dhe të mjaftueshme për të realizuar praktika mësimore cilësore. Përveç laboratorëve të lëndëve bazë ka dhe laboratore specifikuatë dedikuar fizioterapisë.</p> <p>GVJ I vizitoi të gjitha laboratorët gjatë vizitës dy ditore të tij në këtë institucion.</p>
<p>Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni siguron tekste mësimore cilësore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme dhe bashkëkohore;</p> <p>Kriteri 2 Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p> <p>Kriteri 3 Në bibliotekë ka botime periodike dhe librari elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p> <p>Kriteri 4 Përgjegjësit e programit kanë hartuar një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës nga studentët, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për këtë qëllim;</p> <p>Kriteri 5 Biblioteka ka orare të shërbimit në përshtatje me oraret e programeve të studimeve dhe nevojat e studentëve.</p>	<p>Institucioni siguron tekste mësimore në formë cikël leksionesh cilësore përgatitur nga pedagogët dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme dhe bashkëkohore në gjuhën shqipe dhe të huaj.</p> <p>Në bibliotekën e UAL ka literaturë të mjaftueshme rreth 13500 tituj librash gjithsej për programet që ofrohen në këtë institucion.</p> <p>Biblioteka pasurohet në mënyrë periodike me botime (revista shkencore, libra, etj). Titujt në bibliotekë janë klasifikuar sipas profileve dhe disiplinave të programit akademik dhe informatizimi i saj është i klasifikuar, i shoqëruar dhe i pasuruar me informacion mbi materialin në brendësi të librit. Është e disponueshme si për studentët dhe stafin akademik biblioteka online e Organizatës Botërore të Shëndetësisë «Hinari» që ndikon në realizimin e programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës së diplomës.</p> <p>Gjatë vizitës sonë u njohem me literature të re të huaj të sapofurnizuar të porositur enkas për Fizioterapinë. Orari i shërbimit është në përshtatje me orarin mësimor dhe nevojat e studentëve.</p>
<p>Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë të mjaftueshëm dhe mjedise të përshtatshme mësimore.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;</p>	<p>U. Aldent ka vënë në dispozicion të procesit mësimor: laboratorë, klasa, zyra, auditore e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve.</p> <p>Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit.</p> <p>Të gjitha sallat e leksioneve dhe seminareve janë të pajisura me videoprojektor dhe të gjitha mjetet e tjera specifike të fizioterapisë.</p> <p>Janë 3 (tre) laboratorë kryesorë që shërbejnë për të kryer orët laboratorike të lëndëve rehabilituese. Studentët praktikojnë metodat rehabilituese në</p>

<p>Kriteri 3 Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve dhe për zhvillimin e praktikave të parashikuara nga programi i studimit, në përputhje me qëllimet e programit, si dhe mirëmbahen dhe janë në përmirësim të vazhdueshëm;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator, për secilin grup leksionesh ku parashikohen praktika laboratorike.</p>	<p>manekinët mësimorë ose konkretisht me njëri- tjetrit në grupe të vogla.</p> <p>Në këto laboratore gjenden paisjet e nevojshme për procedurat e rehabilitimit si: shtretër profesional për manipulime fizioterapeutike, aparate me ultratinguj, infrared, ketler, bicikleta dhe pista vrapimi, step si dhe mjete të tjera ndihmese për rehabilitim fizioterapeutik. Në ndihmë të mësimdhënies për lëndë profesionale studentët shfrytëzojnë edhe palestrën moderne që gjëndet në ambjentet e universitetit. Këta Laboratorë që përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programit të studimit për zhvillimin e lëndëve që në programin e tyre parashikojnë orë laboratorike.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <p>Infrastruktura në funksion të programit të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera janë optimale në standarde të larta e gjithënjë në përmirësim e sipër.</p> <p><u>Standardet plotësohen</u></p>	

Rubrika 5 - Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

Pjesa përshkrimore

Terma reference: burimet e financimit, kostoja për student, kapacitetet menaxhuese.

Universiteti Aldent është një institucion privat i arsimit të lartë I cili financohet nga burimet e tij të brendshme të financimit. Burimi i financimit të UAL janë tarifat e studentëve. Këto tarifa janë konkurruese në treg. Ka ecuri te qëndrueshme te UAL në të gjitha drejtimit përfshirë atë ekonomik e financiar gjë që flet për mirëmenaxhim nga autoritetet drejtuese. Sipas drejtuesve të UAL dhe Administratorit të saj, qëllimi kryesor i përdorimit të fondeve në këto vite ka qenë:

- Shtimi i infrastrukturës në dispozicion të studentëve si laboratore, auditore, biblioteka etj
- Dyfishimi I sipërfaqes në dispozicion të studentëve I realizuar ne vitin 2014
- Shtimi i numrit të stafit akademik dhe sidomos atyre me grada shkencore dhe që kanë përfunduar studimet jashtë vendit.
- Shtimi i titujve të rinj në bibliotekë, abonimi në bibliotekën online, shtimi i numrit të PC, videoprojektorët, informatizimi, etj.

Studentët në UAL kanë disa lehtësira si:

Studentët nuk paguajnë kosto shtesë përveç tarifës së shkollimit për:

- Ridhënien e provimeve, përsëritjen e vitit shkollor (për 1 vit)
- Për pajisjen me dokumentacion si vërtetime, transferime, çregjistrime, diplomime, etj
- Për pagesa jashtë afatit të kontratës, për praktika mësimore dhe ekspedita jashtë Tiranës
- Transportin nga Qendra e Tiranës në Kampusin Qëndror, i cili është falas.
- Aktivitete kulturore dhe sportive që organizohen nga shkolla
- Aktivitete shkencore si Summer School, Einter School, etj.

- Financimi për veprimtari shkencore si për ato të organizuara nga UAL por edhe sponsorizimi i veprimtarive të organizuara nga institucionet me të cilat bashkëpunohet.
- Donacione me karakter humanitar si sponsorizim për rikonstrukcionin e pavionit të Fizioterpaisë pranë QSUT, Rikonstrukcion i çerdhes nr.23 në vartësi të Bashkisë së Tiranës, sponsorizime të përvitshme në infrastrukturën e QSUT si dhe donacionet e ndryshme në raste fatkeqësish natyrore, për fëmijët jetim, të moshuarit etj.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- *Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në këtë program studimi (në përqindje) gjenden në Aneksë, tabela 14:*
- *Shpenzimet për studentët dhe kosto e studimit për student për vit akademik (në përqindje) gjendet Aë anekse, tabela 15*

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.9 - Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm dhe/ose të brendshëm) të situatës financiare.	
<p>Kriteri 1 Raporti i auditit paraqet të gjithë situatën financiare për përdorimin e buxhetit të vënë në dispozicion për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 2 Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 3 Raporti i auditit analizon eficiencën e përdorimit të të ardhurave nga tarifat e studentëve në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve në këtë cikël studimesh.</p>	<p>GVJ gjatë takimit me drejtuesit e Institucionit u vu në dijeni se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Institucioni kryen auditim vjetor të brendshëm e jashtëm të situatës financiare dhe garanton vërtetësinë e informacionit financiar - Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë dhe Bazuar në Standardin Kombëtar të Kontabilitetit. Auditit verifikon paraqitjen, regjistrimin dhe përpunimin e të gjitha të dhënave, sipas zërave në pasqyrat financiare. - Raporti i auditit analizon eficiencën e përdorimit të të ardhurave nga tarifat e studentëve në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve.
Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një raport që pasqyron të dhëna të hollësishme financiare të kostove për realizimin e programeve të studimeve, si kostot operacionale, kostot fikse të mjediseve dhe të pajisjeve, etj.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon se ka një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programeve të studimeve dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen.</p>	<p>Institucioni harton raporte financiare të hollësishme të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare;</p> <p>Institucioni dokumenton raportet financiare për vitet e kaluara akademike, sic edhe parashikohet nga Standardet Kombëtare të Kontabilitetit dhe i pershkruan edhe në RVB.</p> <p>Institucioni ka aftësi menaxhuese dhe dëshmon një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e shërbim dhënies, si</p>

	<p>dhe rritjes së numrit të përfituesve të shërbimit në të ardhmen.</p> <p>Vetem vitin e fundit (2017), investimet e kryera në: krijim të ambjenteve të reja destinuar mësimdhënies, rehabilitim të atyre ekzistuese destinuar mësimdhënies, informatizimit, arrijnë vlerën prej rreth 370000000 lekë.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <p>Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare janë serioze dhe sipas Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit. Ka qëndrueshmëri financiare dhe kapacitete për rritje të mëtejshme.</p> <p><u>Standardet plotësohen</u></p>	

Rubrika 6 - Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

Pjesa përshkrimore

Terma reference: institucionalizimi i sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, ngritja e Njësisë së SBC, funksionimi i saj, vetëvlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë, rezultatet e vlerësimeve të jashtme.

Grupi I Vlerëimit të jashtëm I kushtoi një rëndësi të vecantë takimit me Njësinë e sigurimit të cilësisë në këtë institucion. Përfaqësuesit e kësaj njësie bënë një prezantim të shkurtër duke përmendur si funksionon kjo njësi, cilat janë detyrat e saj, si bëhej shpërndarja e punëve brenda saj, etj.

Në Universitetin Aldent funksiononte Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë (NJSBC) prej disa vitesh. Kjo njësi kishte si qëllim vlerësimin dhe monitorimin e cilësisë së aktiviteteve të tij dhe komponentëve përbërës të tyre si: programeve mësimore, stafit akademik, administrativ dhe ndihmës, studentëve, mësimdhënies, shërbimeve të logjistikës dhe shërbimeve të tjera që ofron. Ekzistenca e kësaj strukturë është e paraqitur në Statut, Rregulloren e Brendshme të Universitetit Aldent, Rregulloren e NJSBC.

Gjatë takimit me këtë Njësi, na u komunikua se institucioni dokumenton proceset e vlerësimit të performancës nëpërmjet disa kriterëve që vlerësojnë arritjen nga pedagogu të objektivave të lëndës, përmbushjen cilësore të pritshmërisë së studentëve, angazhimine pedagogut për përmirësimin e vazhdueshëm të leksioneve, seminareve, praktikave të zhvilluara, veprimtarinë administrative dhe angazhimin e pedagogut në kërkimin shkencor, etj. Disa nga aktivitetet e Përmirësimit të Vazhdueshëm janë listuar si mëposhtë:

- Monitorimi i performancës së Indikatorëve të Proçeseve
- Rishikimi periodik i Proçedurave/Proçeseve minimalisht 1 herë në 24 muaj.
- Rishikim të objektivave të cilësisë
- Trajnimet
- Aktivitetet e planifikuara të Ekipit të Cilësisë

Kjo njësi merrej edhe me përpunimin e Rezultateve të auditimeve. Konkretisht - të dhënat statistikore analizohen dhe vlerësohen dhe i komunikohen stafit për përmirësimin e performancës së tyre në punën e përditshme. Janë hartuar pyetësorë për t'u plotësuar nga studentët, të cilët konsistojnë në vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe cilësisë së pedagogut. Pyetësorët plotësohen me shkrim ose elektronikisht prej studentëve, kurse rezultatet e analizuara gjenerohen automatikisht për lëndët dhe pedagogët në formën e raporteve. GVJ ju vu në dispozicion edhe një rast konkret I plotësimit të një pyetësori nga një student

Në fund të çdo viti akademik, NJSBC harton një raport vjetor vetëvlerësimi. Kjo njësi ka në përbërje një grup që është i pavaruar.

- Të dhënat për anëtarët e NJSBC, detyrat që kanë dhe kohëqëndrimi në këtë detyrë, gjenden në Anekse, tabela 16

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJSBC për programin e studimit, si:

Viti Akademik	Numri i studentëve të anketuar për programin Master në Fizioterapi Klinike	Numri i pyetjeve të përfshira në formatin e pyetësorit	Problematikat kryesore të hasura	Masat e marra për përmirësimin e problematikave të hasura
2016-2017	32	Dy seksione me nga 10 pyetje	Studentët kishin sugjeruar në sondazh se do të mund të përfitonin me shumë nga ora e mësimit nëse do të kishin mundësi të shkëmbejnë eksperiencat e tyre të punës për disa tema të programit mësimor.	Janë kontaktuar pedagogët, është stimuluar forma interaktive e mësimdhënies, kjo duke respektuar edhe faktin se të gjithë studentët janë profesionistë në punën e tyre dhe shkëmbimi i eksperiencave klinike midis tyre është shumë frytdhënës.
2017-2018 (semesti i parë)	57	Dy seksione me nga 10 pyetje	Nga përpunimi i të dhënave të pyetësorëve të plotësuar nga studentët e Msc. në Fizioterapi Klinike doli në pah nevoja për trajnime të stafit akademik për tu përditësuar me mënyrat më bashkëkohore të komunikimit, mësimdhënies etj.	Janë kryer disa trajnime të stafit akademik në drejtim të metodave pedagogjike, përmirësimin të komunikimit dhe bashkëpunimit me studentët. Trajniet janë kryer nga pedagogë apo specialistë të mirënjohur të fushave të pedagogjisë, sociologjisë, psikologjisë

Gjatë takimit me NJSBC, GVJ ju komunikua se: Anketimet me studentët janë realizuar në mënyrë të vazhdueshme zakonisht në periudhën janar të çdo viti akademik para sezonit të provimeve të periudhës së shkurtit. Numri i studentëve të anketuar ka ardhur në rritje. Anketimi është realizuar në mënyrë elektronike në tre vitet e fundit ku studentët plotësuan pyetësorët dhe rezultatet u përpunuan nga zyra e Informacionit dhe Teknologjisë. Të gjitha anketimet janë përpunuar cdo vit akademik dhe problematikat e dala luhaten midis “ngarkesa e madhe mësimore”, “mësimi nuk është shumë tërheqës”, “lëndë të vështira” si dhe kërkohet të nxitet mësimi interaktiv”. NJSBC u ka raportuar fakulteteve përkatëse problemet lidhur me rezultatet e pyetësorëve. Pedagogët janë vënë në dijeni të ankesave të studentëve që të marin masa në drejtim të komunikimit profesional dhe etik, si dhe përmirësimin e cilësisë së zhvillimit të mësimin për të rritur interesin e formimin e studentëve. Njëpërmjet strukturës së tutoriatit akademik synohej për

ndërgjegjësimin e orientimin e studentëve për përpjekjet që ata duhet të bëjnë për formimin e tyre nga programi i zgjedhur.

Politikat e përmirësimit të cilësisë mbi bazën e vetëvlerësimeve periodike Çdo anëtar i grupit të punës së NJSBC përfaqëson njësinë strukturore të cilës i përket, dhe merr informacionin bazë të auditimit të kësaj strukture dhe e paraqet në tabelat e hartura nga NJSBC. Problematika dhe rezultatet diskutohen në mbledhjet periodike të grupit. Në fund ato paraqiten në raportin vjetor të NJSBC.

Politika që ndiqet për përmirësimin e cilësisë në bazë të kontrolleve periodike është bashkëpunimi me aktorët kyç që marrin pjesë në mësimdhënie dhe komunikon me aktorë jashtë njësisë me rëndësi në funksionimin e institucionit. Problematikat e hasura nga auditimet dhe nga pyetësorët e mësimdhënies dhe të mësimnxënies i transmetohen Rektorit i cili komunikon me Zyrën e Burimeve Njerëzore, e cila mban shënime mbi performancën e stafit. Vendimet mbi hapat që do të merren për përmirësim të problematikave I merr Senati. Të gjithë anëtarët e grupeve të punës së NJSBC janë pedagogë të brendshëm dhe përfaqësues të njësisë kryesore të universitetit, cka lehtëson komunikimin midis njësisë të institucionit. Komunikimi me studentët realizohet nëpërmjet pyetësorëve nga ku raportohet problematika më e rëndësishme e procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.10 - Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin që bën për arritjen e sigurimit të brendshëm të cilësisë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni publikon rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta.</p> <p><u>Të tërthorta:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> • Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve në këto programe në vitet e mëparshme akademike apo në ciklet e ndryshme të studimeve; • Sondazhe të vlerësimit të mësimdhënies, kurrikulës, të të mësuarit; • Pyetje konceptuale; • Intervista; • Etj. <p><u>Të drejtpërdrejta:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> • Rezultatet e arritura nga studentët në teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare 	<p>GVJ konstaton se Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese; gjë që realizohet në disa forma. Janë aplikuar mekanizma të sigurimit të cilësisë ato që kërkohet sot të përdoren nga IAL për ecurinë e programeve të studimeve.</p> <p>Forma kryesore e vlerësimit të ecurisë së programeve të studimit, zhvillohet nëpërmjet marrjes së vlerësimit të studentëve, nëpërmjet plotësimit nga ana e tyre të formularëve të veçantë për cdo lëndë, ku shprehen për cilësinë e organizimit dhe zhvillimit të procesit mësimor, metodologjitë e mësimdhënies, infrastrukturën mësimore e laboratorike, impenjimin e stafit akademik, literaturën e përdorur etj.</p> <p>Të dhënat për ecurinë e programit vihen në dispozicion të organeve drejtuese të Universitetit dhe Zyrës së Burimeve Njerëzore duke I ndihmuar për zhvillimin e politikave e strategjive të reja të zhvillimit të institucionit.</p> <p>Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta.</p> <p>Disa nga metodat e përdoruara, GVJ vecon:</p>

<p>(p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara, etj);</p> <ul style="list-style-type: none"> • Dëgjime në auditor; • Rezultatet e arritura nga studentët në provimet e vlerësuara me nota/pikë; • Rezultatet e arritura nga studentët në testimet paraprake dhe përfundimtare, provimet për module, praktikat profesionale; • Rezultatet e arritura nga studentët në vlerësimin e detyrave të kryera gjatë zhvillimit të programit të studimit (punë individuale apo në grup, detyra kursi për të analizuar të kuptuarit conceptual, referatat, projektet, provimet, etj.); • Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës; • Rezultatet e arritura dhe cilësia e rezultatit të kërkimit - tezës; • Etj. 	<p>-Sondazhe nëpërmjet pyetësorëve të studentëve, ku ata mund të shprehen në kushte anonimiteti për të gjitha këto procese.</p> <p>-Sistemi i Tutorëve/Kujdestarëve të Grupeve të studentëve,</p> <p>-Stafi akademik dhe Administrativ i Universitetit, fton studentët në diskutime të hapura, dhe ju mundëson atyre shprehjen e lirë të gjitha çështjeve që lidhen me procesin mësimor.</p> <p>-Vlerësimi i studentëve bëhet në format e përcaktuara ligjore</p> <p>Të gjithë studentët gjatë kryerjes së praktikave të tyre mbikëqyren nga përgjegjësit e caktuar.</p> <p>Rezultatet e arritura dhe cilësia e tezës, janë gjithmonë çështje të vlerësimit permanent</p>
<p>Standardi I.13 - Institucioni publikon rregullisht informacion të paanshëm dhe objektiv, sasior e cilësor, për vlerësimin e brendshëm.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni publikon rregullisht broshura, buletine etj., të hartuara dhe botuara nga institucioni, për vlerësimin e brendshëm;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni publikon rregullisht prezantime në faqe interneti, video e audio etj. për vlerësimin e brendshëm.</p>	<p>Njësia e brendshme e sigurimit të cilësisë harton çdo vit një raport vjetor për veprimtarinë e saj në institucion. Ky raport hidhet në faqen e ëeb-it të UAL dhe është lehtësisht i aksesueshëm nga studentët, pedagogët por dhe për publikun.</p>
<p>Standardi II.7 - Institucioni kryen një analizë vjetore për vlerësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një analizë vjetore për vlerësimin e ecurisë së programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni harton politika që synojnë përmirësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>Institucioni harton një raport vjetor të veprimtarisë së tij. Në hartimin e këtij raporti marrin pjesë të gjithë aktorët si stafi pedagogjik, administrativ dhe studentët. Në këtë raport përshkruhet ecuria e institucionit gjatë një viti kupërfshihet edhe ecuria e programeve të ciklit të dytë.</p> <p>Mbi këtë bazë hartohen edhe politikat e ndryshme për përmirësimin e programeve. Ky raport hidhet në faqen e web-it dhe një kopje dërgohet edhe në MASR</p>
<p>Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni harton një politikë dhe ndjek procedurën të caktuar për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të tyre;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni përdor mekanizma formale për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimit;</p>	<p>Universiteti "Aldent" është i akredituar institucionalisht. Me urdhër nr.111, dt.11.03.2016, të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë ai është akredituar institucionalisht me vlefshmëri deri në vitin 2022.</p> <p>Sigurimi i Cilësisë në UAL realizohet në forma të ndryshme duke përfshirë instrumentet e duhura dhe rolin aktiv të zyrave të ndryshme pjesë të Institucionit.</p> <p>Janë aplikuar mekanizma për një sigurim sa më të mirë të cilësisë.</p>

<p>Kriteri 5 Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen, për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;</p> <p>Kriteri 6 Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.</p>	<p>Personeli akademik përfshihej në mënyrë të drejtpërdrejtë në procesin e sigurimit të cilësisë, duke u ndërgjegjësuar në rëndësinë e dhënies së kontributeve të drejtpërdrejtë në këtë proces.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <p>Institucioni përdor metodologji vlerësimi të cilësisë, ka ndërtuar dhe disponon instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve. Ka informacion të paanshëm dhe objektiv, sasior e cilësor, për vlerësimin e brendshëm. Kryen analizë vjetore për vlerësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë. - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.</p> <p><u>Standardet plotësohen</u></p>	

Rubrika 7 - Programi i studimit, organizimi i tij

Pjesa përshkrimore

Terma reference: misioni dhe objektivi i programit të studimit, përmbajtja e programit, organizimi i vitit mësimor, semestrat, plani mësimor me të gjithë elementët e tij (lëndët/modulet, kreditet përkatëse, ndarja e orëve për çdo kredit në varësi të formave të studimit, orët mësimore përkatësisht në auditor/jashtë auditorit të ndara sipas formave të mësimdhënies), literatura dhe materiale të tjera mbështetëse e ndihmëse, etj

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

√ - Viti i fillimit, qëllimet dhe objektivat e çdo programi studimi

Me Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës Nr 195, dt 28.5.2013 është licensuar programi i studimit të ciklit të dytë "Master i Shkencave" në "Fizioterapi Klinike" (2 vite akademike - 120 kredite ECTS). Duhet vënë në dukje se aktivizimi i këtij programi nisi në vitin akademik 2016-2017, duke shënuar tanimë vitin e tij të dytë të veprimtarisë. Programi gjendet ne Anekse.

Programi i studimit të ciklit të dytë në Msc. në "Fizioterapi Klinike" synon dhe ka si objektivi:

- Të përgatisë fizioterapeut të aftë me njohuri e kompetenca të nevojshme fizioterapeutike profesionale që t'i përgjigjen kërkesave të larta teorike dhe praktike që kërkohen sot në fushën e rehabilitimit.
- Aktivizimin dhe nxitjen e studentëve që të jenë pjesëmarrës në aktivitete të vazhdueshme shkencore, sociale dhe kulturore.

- Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit:

Ndarja e aktiviteteve didaktike është kryer sipas Udhëzimeve të MASR dhe paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Ndarja e aktiviteteve didaktike		
<i>Aktiviteti didaktik</i>	Orë në auditor/ ECTS	Orë studimi individual/ ECTS
<i>Leksione (L)</i>	6- 12	9- 13
<i>Seminare (S)</i>	6-8	9-17

Laboratorë(lab)	18- 25	0- 7
Praktika (p)	20- 25	0- 5
Diploma	2	23

Disiplinat mësimore dhe veprimatritë e tjera formuese që ofrohen në këtë program studimi janë të organizuara në 6 kategori, nga A – F në zbatim të akteve nënligjore që përshkruajnë organizimin e programit. Këto disiplina dhe kreditet e tyre rishikohen në mënyrë periodike. Ndryshimet propozohen nga njësia bazë përgjegjëse dhe miratohen nga dekanati përkatës.

Në tabelat e mëposhtme është paraqitur shpërndarja e disiplinave në programin Master Shkencor në “Fizioterapi Klinike”.

Fizioterapi		Fusha Disiplinore	Nr. i krediteve dhe %	
A	Lëndë të formimit të përgjithshëm bazë		12	10 %
B	Lëndë karakterizuese		60	50 %
C	Lëndë të ngjashme, integruese		10	8.3 %
D	Lëndë me përzgjedhje		8	6.8 %
E	Lëndë formuese për njohjen e gjuhës së huaj, aftësive informatike praktika, stazhe		10	8.3 %
F	Teza e diplomës		20	16.6 %
			120	100%

Veprimtaria mësimore është organizuar sipas sistemit me 2 semestra. Veprimtaritë mësimore në fushën përkatëse karakterizohen edhe nga veprimtaria kërkimore dhe krijuese, aktivitete të konceptuara në mbështetje të programit të studimit.

Në program janë parashikuar lëndët dhe kreditet përkatëse, po ashtu dhe organizimi i tyre në orë mësimore dhe studim individual. Studentët nxiten të kryejnë kërkim individual gjatë zhvillimit të lëndëve nëpërmjet detyrave kurse me tema profesionale të ndryshme. Plani mësimor është i organizuar në mënyrë të tillë:

1 vit akademik ka 30 javë mësimore në auditor

1 Semestër ka 15 javë mësimore në auditor

1 ECTS = 25 orë mësimore punë të studentit

1 orë mësimore = 60'

Ky program studimi ofrohet vetëm me kohë të plotë. Secila disiplinë ka lëndën apo modulet përkatëse, të cilat janë të shprehura në orë mësimore dhe kredite.

Vlerësimi i dijeve organizohet për çdo modul. Studentët do të kenë mundësinë e vlerësimit të efektshmërisë së tyre dhe mësimdhënies në të dy komponentët, teorikë dhe praktikë në varësi të disiplinës.

Nën përgjegjësinë e departamenteve organizohen edhe aktivitete të tutoriatit për studentët, në përputhje me rregullat e përcaktuara në rregulloren e tutoriatit.

Në veprimtaritë e tutoriatit përfshihet i gjithë personeli akademik i programit të studimit. Vlen të theksohet se UAL ka vënë në funksion të tutoriatit akademik një hapësirë brenda platformës elektronike në të cilën çdo pedagog kujdestar pasqyron frekuentimin dhe ecurinë e studentëve që ka nën tutorim.

Në 2 vite akademike, numri i përgjithshëm i lëndëve të programit të studimit është 13, koform akteve ligjore në fuqi. Plani mësimor i aprovuar për të dy vitet e programit Msc. në “Fizioterapi Klinike”

- *Ndarja e Veprimtarive Formuese (A-F) gjendet në Aneksë, tabela 17*
- **Nuk ka ndryshim në planin mësimor që nga koha e licensimit të këtij programi studimi (Shiko anekset, Plani mësimor)**
- *Plani mësimor i lidhur me personelin akademik përkatës për vitin akademik 2017-2017, gjendet në anekse, tabela 18*

Të gjitha lëndët kanë si titullarë pedagogë me titull, efektiv ose me kontratë pranë universitetit. Staf i efektiv mbulon 76% të ngarkesës mësimore në auditor duke përfshirë edhe orët e praktikës mësimore të cilat mbulohe nga staf i brendshëm

Në këtë program studimi angazhohen në mësimdhënie edhe pedagogë që kanë titullin Msc, në kundërshtim me LAL 80/2015. Është për tu përmendur fakti që disa prej këtyre pedagogëve kanë formim Mastër në Universitetet e BE-së dhe kanë disa vite eksperiencë në mësimdhënie.

Në fillim të çdo viti akademik përgatitet nga pedagogët e përzgjedhur syllabusi i lëndës/modulit, përmbajtja e të cilit mbështetet në standartet kombëtare të cilësisë për arsimin e lartë dhe përmban të gjithë elementët e nevojshëm të aprovuar nga senati akademik.

Çdo pedagog depoziton në njësinë përkatëse para fillimit të semestrit programin e detajuar. Dosja me karakteristikat e çdo lënde studjohet në nivel departamenti dhe pasi shihet se është në përputhje me modelin e Fakultetit dhe departamentit, miratohet. Modeli i një syllabusi me të gjithë elementët e përmbajtjes së tij i është bashkëlidhur raportit të Vlerësimit të brendshëm.

Kontrolli i dijes së një lënde (provimi) mund të bëhet nëpërmjet:

- Provimit me shkrim
- Provimit me gojë
- Vlerësimit të projektit apo aplikimit konkret të metodave specifike rehabilituese në grupe prej dy ose më shumë studentësh.
- Kombinimit të formave të mësipërme: me shkrim, me gojë, projekt dhe aplikim praktik.

Senati Akademik ka përcaktuar raportet në % që do të zënë të gjithë komponentët e mësimin në vlerësimit përfundimtar.

Shëmbull: Format e kontrollit të njohurive	Pjesa (në %) ndaj totalit
Ndjekja e lëndës dhe pjesmarrja aktive	10%
Plotësimi i detyrimeve (laboratorike, detyrave të kursit)	20%
Testimet gjatë vitit	10%
Provimi përfundimtar	60%
Në total	100%

Në Syllabus përshkruhet edhe literatura e detyrueshme dhe ajo e rekomanduar.

GVJ pa një shëmbull syllabusi, konkretisht syllabusin e lëndës “Rehabilitim në Onkologji dhe Hematologji”, i cili është paraqitur me anekse në RVB. Gjate vizitës në vend, GVB-së ju kerkuan edhe syllabuset e disa lëndëve të tjera, të cilat ishin të mjaftueshme për të gjykuar mbi përmbajtjen e tyre. Syllabuset plotësojnë të gjitha standardet e përcaktuara nga udhezimet dhe aktet ligjore të MASR.

Bazuar në VKM dhe Udhëzimet e MASR për këtë vit 2018 është e nevojshme, që në një të ardhme të afërt, të mos ketë më pedagogë që japin mbi 3 lëndë, thënë kjo sepse kishte pedagogë që jepnin më shumë lëndë.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);</p> <p>Kriteri 2 Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;</p>	<p>Institucioni ofron program studimi Msc, të organizuar në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);</p> <p>Ky program është në proces akreditimi.</p> <p>Respektohet sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student, që ndjek një program studimi me kohë të plotë dhe është 60 kredite</p>
Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	
<p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave”, “Master i arteve të bukura” apo “Master Profesional” i pajisin studentët që zotërojnë diplomën universitare “Bachelor” me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor apo trajnim të mirëfilltë profesional;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe “Master Profesional” synojnë të zgjerojnë njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimeve;</p> <p>Kriteri 4 Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë (në mjekësi, stomatologji, farmaci, veterinari, arkitekturë) i pajisin studentët me njohuri të thelluara dhe kompetenca shkencore, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor sipas fushës. Pas përfundimit të tyre si dhe përfundimit me sukses të provimit të shtetit për programin specifik, studentët fitojnë të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar sipas ligjit në fuqi;</p> <p>Kriteri 5 Programet e studimeve të këtij cikli i pajisin studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale që synohen të arrihen apo të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij;</p> <p>Kriteri 6 Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë krijojnë baza të qëndrueshme njohurish për studimet e ciklit të tretë doktoratës, duke përfshirë aftësimin për</p>	<p>Programet e studimeve të ciklit të dytë si “Master i Shkencave”, në Fizioterapi Klinike i pajisin studentët që zotërojnë diplomën “Bachelor” me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor apo trajnim të mirëfilltë profesional;</p> <p>Me qëllim aftësimin e tyre për kërkim shkencor ofrohen module të tilla si biostatistika, informatika, metodat e kërkimit shkencor në fizioterapi, etj</p> <p>Programet e studimeve të ciklit të dytë si “Master i Shkencave”, në Fizioterapi Klinike synojnë të zgjerojnë njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimeve; dhe aplikimin e këtyre njohurive në praktikën profesionale</p> <p>Programet e studimeve të ciklit të dytë si “Master i Shkencave”, në Fizioterapi Klinike japin mundësinë pas përfundimit të tyre si dhe përfundimit me sukses të provimit të shtetit për programin specifik, si dhe të drejtë të ushtrimit të një profesioni të rregulluar sipas ligjit në fuqi;</p> <p>Programet e studimeve të këtij cikli i pajisin studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale që synohen të arrihen apo të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij; në Konferencën e 3-të Shkencore Studentore që do të organizohet në muajin maj 2018 pranë UAL student të këtij programi studimi do të referojnë 5(pesë) tema shkencore.</p>

<p>kërkimin shkencor dhe plotësimin e parakushteve (njohuri, aftësi dhe kompetenca) për pranimin në ciklin e tretë të studimeve; Kriteri 7 Programet e studimeve “Master Profesional” kanë objektiva të qartë profesionale, të justifikueshëm, të arritshëm, me synime të qarta për arritjen e kualifikimit të nevojshëm dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>	<p>Programet e studimeve të ciklit të dytë si “Master i Shkencave” në Fizioterapi Klinike jep mundësinë që mbi bazën e njohurive të fituara të vazhdohet doktoratura me sukses. Nuk I takon këtij programi</p>
Standardi I.4 - Programet e studimeve ofrohen në përshtatje me nivelin e studimeve.	
<p>Kriteri 1 Përbajtja dhe renditja e objektivave të programeve të studimeve synojnë arritjen e qëllimeve të tyre në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato; Kriteri 2 Metodot e vlerësimit të studentëve nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm të njohurive me anë të testeve me përgjigje alternative apo provimeve përfundimtare dëshmojnë ecurinë dhe arritjet e studentëve për ciklin përkatës të studimeve.</p>	<p>Përbajtja dhe renditja e objektivave të programeve të studimeve synojnë arritjen e qëllimeve të tyre në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato; Metodot e vlerësimit të studentëve nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm dhe përfundimtar të njohurive me anë të testeve me përgjigje alternative apo provimeve përfundimtare dëshmojnë ecurinë dhe arritjet e studentëve për ciklin përkatës të studimeve.</p>
Standardi I.5 - Programet e studimeve synojnë të arrijnë dimensione ndërkombëtare.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve mbështeten në përvojën disavjeçare dhe praktikat e mira të vendeve europiane; Kriteri 2 Programet e studimeve janë ndërkombëtarisht konkurruese për nga elementet që përmbajnë (të dhëna të përgjithshme, objektivat kryesorë, plani mësimor, kreditet, kushtet e pranimit në tometodat e vlerësimit, kriteret dhe procedurat e transferimit të krediteve e njohurive të fituara, diplomat që jepen në përfundim etj.) duke afirmuar vlerat e arsimit universitar në Shqipëri; Kriteri 3 Programet e studimeve janë hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara.</p>	<p>Programet e studimeve mbështeten në përvojën disavjeçare dhe praktikat e mira të vendeve europiane; ai është konsultuar me ekspertë të huaj të fushës nga Itali, Spanjë e Çeki. Programi i studimit është ndërkombëtarisht konkurruese për nga elementet që përmbajnë (të dhëna të përgjithshme, objektivat kryesorë, plani mësimor, kreditet, kushtet e pranimit në to dhe metodat e vlerësimit, kriteret dhe procedurat e transferimit të krediteve e njohurive të fituara, diplomat që jepen në përfundim etj.) duke afirmuar vlerat e arsimit universitar në Shqipëri; Nga të dhënat e studentëve të diplomuar pranë UAL në ciklin e parë në Fizioterapi, është konstatuar se, disa prej tyre kanë arritur të punësohen jashtë vendit duke bërë njehsimin e diplomës në shtete të huaja. Programet e studimeve janë hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara.</p>
Standardi I.6 - Programet e studimeve përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor; Kriteri 2 Programet e studimeve hartohen në përputhje me profilin e Institucionit të Arsimit të Lartë dhe strategjinë e tij për zhvillim;</p>	<p>Programet e studimeve të ciklit të dytë si “Master i Shkencave”, në Fizioterapi Klinike përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor; në Konferencën e 3-të Shkencore Studentore që do të organizohet në muajin maj 2018 pranë UAL student të këtij programi studimi do të referojnë 5(pesë) tema shkencore.</p>

<p>Kriteri 3 Personeli akademik angazhohet në punën kërkimore shkencore për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 4 Puna kërkimore e personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimeve përkon me synimet për arritjen e qëllimeve të tij.</p>	<p>Programet e studimeve hartohen në përputhje me profilin e Institucionit të Arsimit të Lartë dhe strategjinë e tij për zhvillim; Ky institucion është fokusuar vetëm në drejtimin e mjekësisë.</p> <p>Personeli akademik angazhohet në punën kërkimore shkencore për realizimin e programeve të studimeve; cka publikohet apo referohet në aktivitete shkencore.</p> <p>Puna kërkimore e personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimeve përkon me synimet për arritjen e qëllimeve të tij dhe kryhet edhe në shërbim të marrjes së titujve e gradave shkencore.</p>
<p>Standardi I.7 - Programet e studimeve “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” synojnë të plotësojnë nevojat në sektorët përkatës të ekonomisë vendase apo të huaj.</p>	<p>Nuk i përket këtij vlerësimi</p>
<p>Standardi I.8 - Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës, dhe hartohen në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p> <ul style="list-style-type: none"> • mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, komëtar a ndërkombëtar; • kërkesat e punëdhënësve; • një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program; • numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra. 	<p>Duke parë rritjen e numrit të studentëve si dhe rritjen e kërkesave të tregut për specialist të fushës së fizioterapisë, GVJ mendon se ky program studimi është një nevojë e kohës dhe tregut të punës. Kualifikimi i mëtejshëm i studentëve që tashmë kanë një diplomë bachelor do të ndikojë në rritjen e cilësisë së shërbimit shëndetësor në vendin tone.</p> <p>Ka student aktualisht të punësuar apo vetëpunësuar akoma pa mbaruar studimet.</p> <p>Parashikimi i kuotave hartohet në varësi të kërkesave të tregut të punës por edhe të studentëve që përfundojnë studimet bachelor në këtë program studimi edhe nga institucione të ngjashme. Kërkesat kanë qenë të shumta por në përputhje me burimet njerzore dhe infrastrukturore në UAL, numri maksimal i studentëve të parashikuar në këtë program studimi është 40 studentë.</p> <p>Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike merr parasysh nevojat e tregut të punës në përcaktimin e kuotave vjetore të pranimeve të reja cdo vit akademik.</p>
<p>Standardi I.9 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interes kombëtare;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>	<p>GVJ konstatoi se Institucioni synon të ruajë vlerat kulturore kombëtare sic janë gjuha, historia, simbolet kombëtare, traditat dhe të përgatisë profesionistë të ardhshëm të cilët do të shërbejnë duke ruajtur këto vlera</p>
<p>Standardi I.12 - Kohëzgjatja dhe numri i krediteve për programet e studimeve të këtij cikli janë në përputhje me me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve “Master i Shkencave” realizohet me 120 kredite</p>	<p>Programi i studimeve “Master i Shkencave në Fizioterapi Klinike” realizohet me 120 kredite europiane ECTS, ku</p>

<p>europiane ECTS, ku përfshihen 30-40 kredite europiane ECTS për projektin kërkimor dhe tezën që duhet përgatitur në përfundim të këtyre programeve të studimeve. Kohëzgjatja normale e tyre është 2 vite akademike;</p>	<p>përfshihen 20 kredite europiane ECTS për projektin kërkimor dhe tezën që duhet përgatitur në përfundim të këtyre programeve të studimeve. Kohëzgjatja normale e këtij programi është 2 vite akademike.</p>
<p>Standardi II.6 - Institucioni siguron menaxhimin efikas të informacionit në lidhje me programet e studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Informacioni i ofruar për programet e studimeve, modulet dhe syllabuset është lehtësisht i konsultueshem për studentët; Kriteri 2 Informacioni për programet e studimit, modulet dhe syllabuset ofrohet në forma të ndryshme të shkruara dhe elektronike.</p>	<p>Gjayë takimit me stafin akademik por edhe me studentët, GVJ konstatoi se studenti informohet nga pedagogu në fillim të cdo lënde apo moduli mbi përmbajtjen e syllabus-eve dhe ka të drejtë të ketë një kopje të shkruar apo elektronike. Modelet e syllabuseve gjenden lehtësisht ne faqen e ëeb të UAL</p>
<p>Standardi II.8 - Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë parashikojnë një plan diplomimi.</p>	
<p>Kriteri 1 Plani i diplomimit shpjegon mënyrën e diplomimit në përfundim të studimeve brenda afatit të parashikuar; Kriteri 2 Për realizimin e programeve të studimeve “Master i Shkencave” janë parashikuar 30-40 kredite për projektin kërkimor dhe tezën.</p>	<p>Gjatë takimit me studentët, ata pohuan se cdo student paraqet pranë dekanatit, përzgjedhjen e tij të lirë në lidhje me fushën e kërkimit, temën, udhëheqësin shkencor dhe më pas pritet të miratohen nga dekani. Nëse studeni nuk e ka paraqitur kërkesën e tij, tema përcaktohet nga departamenti. Tema dorezohet disa javë para mbrojtjes përfundimtare. Për tezën e diplomës janë parashikuar 20 kredite ECTS në planin mësimor.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <p>Në këtë program studimi angazhohen personel akademik që janë me titull Msc, edhe pse shumica prej tyre kanë eksperiencë në mësimdhënie, prap kjo është në kundërshtim me Ligjin e arsimit të Lartë 80/2015, neni 59 pika 6 “Personeli akademik, që anagazhohet në mësimdhënie, duhet të ketë së paku kualifikim të ciklit pasardhës.” Por duke iu referuar tabelave të Stafit akademik të programit të studimit për vitin akademik 2017-18 krahasuar me 2016-17 ka ndryshime me përmirsim të dukshëm në rekrutimin e stafit, angazhim I dukshëm I drejtuesve të UAL në këtë drejtim. Nga Drejtuesit e Institucionit na u konfirmua angazhimi I këtij Institucioni për mbështetjen e stafit për rritjen e kualifikimit të tyre në programet Dr apo edhe rekrutime të reja me tituj dhe grada shkencore.</p> <p>Studimet në këtë program organizohen në module dhe vlerësohen në kredite (ECTS). Vlerësimi i studentëve realizohet nëpërmjet kontrollit të njohurive të ndërmjetme dhe të vazhdueshme si dhe provimet përfundimtare. Ky program studimi është një nevojë e kohës e tregut të punës dhe përgatitja e profesionistëve do të ndikojë në rritjen e cilësisë së shërbimit shëndetësor në vendin tone. Për tezën e diplomës janë parashikuar 20 kredite ECTS në planin mësimor dhe studenti përzgjedh vetë fushën e studimit për temën.</p> <p><u>Standardet plotësohen kryesisht</u></p>	

Rubrika 8 - Mësimdhënia

Pjesa përshkrimore

Terma reference: organizimi i mësimdhënies, format e mësimdhënies, ngarkesa dhe cilësia e realizimit, kontrolli i njohurive të studentëve, metodat e mësimdhënies, teknologjitë e mësimdhënies, vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies, aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj.

GVJ mbështetur në Regulloren e Fakultetit konstaton se çështjet që lidhen me organizimin e mësimdhënies, format, metodat e teknologjitë e mësimdhënies, ngarkesa dhe cilësia e realizimit, kontrolli i njohurive të studentëve, vlerësimi i brendshëm, shpjegohen në këtë rregullore. Objektivat synojnë rritjen e cilësisë së mësimdhënies në nivelet bashkëkohore bazuar në ndërthurjen e teorisë me praktikën dhe kanë për qëllim nxitjen e studentit për të qënë pjesë aktive e procesit. Mësimdhënia në këtë institucion realizohej me disa forma si:

Puna në grup - Gjate orëve të seminareve, punëve praktike apo laboratorike, zhvillohen ushtrime apo punë në grupe. Sipas natyrës së lëndës/modulit dhe projektit, madhësia e grupeve të punës varion nga 2 deri 5 studentë. Veç përfitimit akademik, synohej që puna në grup të nxiste zhvillimin e aftësive, për të cilat ka kërkesa të mëdha nga punëdhënësit, si: aftësitë e bashkëpunimit dhe shkëmbimit të ndërsjellë të eksperiencës.

Prezantimet - Aftësimi i studentëve në teknika prezantimi dhe komunikimi me të tjerët ishte prioritet i Institucionit. Studentët i komunikuan GVJ se fillojnë të bëjnë prezantime të hapura që në vitin e parë akademik. Cilësia dhe teknikat e prezantimit bëjnë pjesë në sistemin përfundimtar të vlerësimit të lëndëve.

Praktikat - Praktikat profesionale të studentëve dhe trajnimet e tyre organizohenin në laboratorët dhe mjedise të tjera të institucionit ose në institucione të tjera private a publike, me të cilat intitucioni ka marrëveshje bashkëpunimi. UAL bashkëpunon me Qendrën spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Spitalin Universitar të Traumës, “Shtëpia e Zotërinjve”, Kolegjin “HEIMERER” etj.

Kontrolli i njohurive dhe format e kontrollit- Forma e kontrollit të dijes bëhej përmes sistemit të vlerësimit me elementë të shumëfishtë. Për të vlerësuar njohuritë e studentit përdoret sistemi shqiptar i vlerësimit me 10 nota (nga 1 tek 10, ku 10 është vlerësimi maksimal). Shkalla e përvetësimit të dijeve me shkrim dhe/ose me gojë bëhet me pikë nga 0-100 pikë dhe rezultati përfundimtar konvertohet në notë nga 4 (katër) në 10 (dhjetë) sipas tabelës së mëposhtme:

Pikët	0-40	41-50	51-60	61-70	71- 80	81-90	91-100
Notat	4	5	6	7	8	9	10

Në vlerësimin përfundimtar të studentit në një disiplinë të caktuar merrej në konsideratë të gjitha elementet përbërëse të zhvillimit të lëndës: pjesa teorike, pjesa e seminareve, projektet, kontrollet e pjeseshme, etj. të detajuar në syllabus. Provimet zhvilloheshin brenda periudhave të caktuara në strukturën mësimore të vitit akademik. Senati Akademik ka përcaktuar raportet në % që do të zënë të gjithë komponentët e mësimit në vlerësimin përfundimtar. Ky vlerësim varet nga kreditet e lëndës, kohëzgjatja e saj si dhe shumë faktorë të tjerë të cilët janë marrë parasysh në hartimin e kësaj tablele përmbledhëse. Kjo mënyrë vlerësimi ju bëhet e qartë studentëve nga të gjithë pedagogët që në fillim të lëndës.

Në format e kontrollit, me shkrim, përdoret sistemi i vlerësimit me pike. Tezat e provimit, në të gjitha rastet e kontrollit, hartohen nga titullari i lëndës dhe miratohen e nënshkruhen nga përgjegjësi i departamentit. pajiset nga sekretaria me bar-kod individual për çdo student dhe çkodohet pas korigjimit nga pedagogu.

Si finalizim i të gjitha detyrimeve akademike studentët i nënshkruhen procesit të mbrojtjes së diplomës. Ky proces për programin e Msc. në Fizioterapi Klinike përfshin mbrojtjen e një teze diplome para komisionit të aprovuar nga departamenti. Aktualisht në këtë program studimi nuk ka student të diplomuar

Programi i Studimit Master Shkencor në Fizioterapi Klinike		
Format e mësimdhënies		Orët totale në auditor
a.	Leksione	851
b.	Seminare	116
c.	projekte	8
d.	Laboratore	9
e.	Praktikë profesionale	200
f.	Teza diplomës	100
Në total		1284

Vihet re se plotësohen standardet e nr. të orëve gjatë një viti akademik në total 1284 që zbaton ligjin, i cili përcakton jo më shumë se 1500 orë.

Format e kontrollit të njohurive	Pjesa (në %) ndaj totalit
Ndjekja e lëndës dhe pjesmarrja aktive	10%
Plotësimi i detyrimeve (laboratorike, detyrave të kursit)	20%
Testimet gjatë vitit	10%
Provimi përfundimtar	60%
Në total	100%

- *Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë gjendet ne Aneke, tabela 19*

Rubrika 9 - Studentët

Pjesa përshkimore

Terma reference: procedurat e pranimit të studentëve, cilësia në hyrje e studentëve, numri i studentëve në hyrje dhe në dalje në vite, koha mesatare e zgjatjes së studimeve, kalueshmëria e studentëve dhe problemet që lidhen me të, statistika, punësimi i të diplomuarve, komunikimi me ish-studentët e diplomuar, informimi i studentëve.

GVJ ju komunikua nga drejtuesit se kuotat e pranimit të studentëve në të gjitha programet e studimit miratohen nga Senati Akademik bazuar në burimet njerëzore, infrastrukturën dhe standardet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

Pranimi i studentëve në programin Msc. në “Fizioterapi Klinike” është kryer në mbështetje të ligjit të arsimit të lartë, si dhe kritereve të përcaktuar në vendimin Nr 47, datë 30.12.2016 të Senatit akademik të Universitetit “ALDENT”

Institucioni ka pranuar regjistrimin e studentëve në programin Msc. në Fizioterapi Klinike për ata studentë të cilët kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve dhe kanë diplomë Bachelor në Fizioterapi. Për pranimin e studentëve ndiqet një procedurë e përcaktuar, që nga aplikimi, intervista, rankimi dhe regjistrimi i studentëve. Në procedurë është vendosur që studentët 70% të pikëve të marrin nga nota mesatare e bachelorit dhe 30% nga intervista me komisionin e ngritur posaçërisht për këtë qëllim.

- Të dhënat për studentët e rregjistruar në vitet akademike 2016-2017 dhe 2017-2018 gjenden në tabela 20

Programi i studimit Msc në Fizioterapi	Studentë të regjistruar për herë të parë në vitin akademik	Nota Mesatare	Studentë të regjistruar me transferim	Nota Mesatare
2016-2017	40	7.15	0	
2017-2018	40	7.32	0	
Në total	80			

Mobiliteti i studentëve brenda sistemit të arsimit të lartë në vend

Periudha/Viti i studimit	Studentë të regjistruar në vitin e parë	Studentë në total për programin	Kalueshmëria
2016-2017	40	38	95%
2017-2018	40	76	-

Transferimet- Në ciklin e dytë të studimeve në programin Msc. në Fizioterapi Klinike nuk ka patur kuota për studentë të transferuar mbasi periudha e shkurtër kohore e programit nuk krijon mundësinë e transferimeve.

Veprimtaritë studentore - UAL e konsideron dhe kujdeset për studentët për ti angazhuar ata në veprimtari të ndryshme ekstrakurrikulare. UAL dhe strukturat e saj synojnë që studentët të ndjehen pjesë aktive e komunitetit ku bëjnë pjesë, duke u angazhuar në aktivitete kulturore, artistike, dhe sportive.

Senati Studentor përgjigjet për nisma, vendime, dhe marrëveshje në lidhje me jetën dhe veprimtaritë studentore dhe kanë të drejtën të organizojnë veprimtari të ndryshme si: pjesëmarrja në klube studentore, ekskursionet, udhëtime, dhe mbledhje shoqërore, gjatë vitit akademik. Universiteti “Aldent” organizon kampionatin e përvitshëm të futbollit nëpërmjet programeve dhe grupeve të ndryshme studentore.

Po kështu gjatë vitit akademik studentët marrin pjesë në leksione të hapura, konferenca, kongrese të organizuara nga institucioni, apo institucionet e bashkëpunimit, sidomos në ditët e promovimit të shëndetit si Dita Botërore e luftës kundër HIV/AIDS, javën Europiane të Parandalimit të Kancerit të Qafës së Mitrës, Ditën Botërore të Autizmit, Konferenca të tjera studentore, etj.

UAL organizon shkolla verore dhe dimërore në të cilin kanë marrë pjesë shumë studentë. Këto shkolla sponsorizohen nga Universiteti në një masë të caktuar dhe organizohen në bashkëpunim edhe me shoqata studentore të Universitetit të Mjekësisë Tiranë.

Zyra e Karrierës në UAL, ofron këshillim për zhvillimin e karrierës për të gjithë studentët. Qëllimi kryesor është që t'u vijë në ndihmë si atyre që vazhdojnë studimet edhe atyre që kanë përfunduar studimet në UAL, për tu mirëorientuar në tregun e punës. Zyra e karrierës mban kontakte të vazhdueshme me studentët e diplomuar për ndjekjen e karrierës së tyre profesionale si dhe për t'i njoftuar me mundësi punësimi dhe aktivitete të edukimit në vazhdim që organizohen nga UAL. Një shembull ndër aktivitetet e organizuara nga Zyra e karrierës ishte prezantimi i projektit “Eòrk&Travel USA 2017” që synonte mundësinë e punësimit të studentëve gjatë sezonit veror në SHBA, si një mundësi e mirë për t'u edukuar me disiplinën e punës dhe gjithashtu për të praktikuar gjuhën angleze. Ky projekt është një ndër mundësitë që UAL ju ofron studentëve si një institucion i pranuar për aplikim nga Ambasada e Sheteteve të Bashkuara të Amerikës në Tiranë.

Studentët e këtij programi studimi diplomohen për herë të parë në këtë vit akademik kështu që nuk jepen të dhëna për punësimin e tyre.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi IV.1 - Studentët kanë të drejtë të ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.	
<p>Kriteri 1 Studentët që ndjekin programet e studimeve “Master i Shkencave” apo “Master Profesional” zotërojnë së paku diplomën universitare “Bachelor” dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS;</p> <p>Kriteri 2 Pranimi në programet e integruara të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 3 Studentët plotësojnë kriteret e pranimin të përcaktuara nga institucioni;</p> <p>Kriteri 4 Studentët e këtyre programeve të studimit japin deri në diplomim edhe provimin e gjuhës angleze mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare. Për programet e studimeve “Master Profesional” niveli i gjuhës angleze është B2, ndërsa për programet e studimeve “Master i Shkencave” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë niveli i gjuhës angleze është C1, sipas Kuadrit Europian të Gjuhëve;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni vlerëson herë pas here politikat e pranimin dhe ndikimin e tyre në përparimin e mëtejshëm të studentëve në programin e studimit, si dhe harton plane të mundshme për ndryshimin e kriterëve të pranimin.</p>	<p>Studentët që pranohen në programin e studimit “Msc” në ‘Fizioterapi Klinike’ kanë diplomën Bachelor në Fizioterapi dhe kanë fituar 180 kredite. Mund të pranohen edhe student të cilët plotësojnë studimet nga Master Profesional në Master I Shkencave, por raste të tilla nuk ka patur.</p> <p>Pranimi i studentëve në programin Msc. në “Fizioterapi Klinike” është kryer në mbështetje të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe urdhërat dhe udhëzimet e nxjerra për këtë problem.</p> <p>Me vendimin Nr 47, datë 30.12.2016 Senati Akademik i Universitetit “ALDENT” ka përcaktuar kriteret e pranimin të institucionit për këtë program studimi. Studentët plotësojnë kriteret e pranimin të përcaktuara nga institucioni;</p> <p>Ndër kriteret që duhet të plotësojë student para se të regjistrohet është edhe mbrojtja e një gjuhe të huajne nivelin minimal B1 deri në C1.</p> <p>Institucioni ka vlerësuar politikat e pranimin dhe ndikimin e tyre në përparimin e mëtejshëm të studentëve në programin e studimit, UAL është bazuar në burimet e veta njerzore dhe infrastrukturën që</p>

	disponon, si dhe ka hartuar plane të mundshme për ndryshimin e kriterëve të pranimit.
Standardi IV. 2- Institucioni informon studentët në lidhje me: statusin e institucionit, të programeve të studimeve që ofron dhe me politikën e punësimit.	
<p>Kriteri 1 Studentëve u jepet informacion për mundësitë për punësim pas diplomimit në përfundim të këtyre programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Studentëve u jepet informacion për akreditimin e institucionit dhe të programeve të studimeve që ofrohen si edhe për njohjen dhe vlefshmërinë, brenda dhe jashtë vendit, të diplomës së lëshuar nga ky institucion;</p> <p>Kriteri 3 Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës.</p>	<p>Studentët e UAL informohen për të gjitha detajet e programit të studimit dhe mundësitë që u krijon për punësim ky program, nëpërmjet faqes zyrtare e cila është aktive dhe përditësohet Vazhdimisht nëpërmjet katalogëve të Universitetit. si dhe nëpërmjet platformës elektronike FxEducation. Studentët kanë informacion për akreditimin ata janë vetë pjesëmarrës në procesin e akreditimit si bashkëbisedues me ekspertët e Vlerësimit të Jashtëm, apo si anëtar të grupeve të Vlerësimit të Brendshëm. Studentët e UAL kanë informacion për vlerën e diplomës së UAL dhe njohjen e diplomës edhe jashtë vendit. Institucioni i ndihmon këta studentë me dokumentacione shtesë kur është e nevojshme apo kërkesë e tyre.</p> <p>UAL ndjek politika mbështetëse për ecurinë e studentëve dhe për këtë qëllim funksionon Zyra e Këshillimit të Karrierës e cila organizon leksione të hapura, seminare ku studentët informohen hollësisht për mundësitë e punësimit pas diplomimit në këtë program studimi.</p>
Standardi IV. 3- Institucioni, kur aplikon për vlerësimin dhe akreditimin për herë të dytë, disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve në programet e studimeve që kanë përfunduar;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik;</p> <p>Kriteri 3 Institucion disponon të dhëna për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim.</p>	<p>UAL disponon të dhëna të plota për çdo student në format elektronik dhe të shkruar, edhe për numrin e të diplomuarve. (Ky program nuk ka ende të diplomuar).</p> <p>Nga dokumentacioni që mbahet nxirren të dhëna për studentët e regjistruar, për studentët që largohen nga programi apo ndërpresin studimet për arsye të ndryshme.</p> <p>Në sekretarinë e institucionit ka regjistër të notave, regjistër të diplomave. Po ashtu ka dhe klasifikim të dokumentacionit pra që ruhen nga momenti i pranimit deri në diplomimin e studentëve, madje një pjesë e tyre janë me ruajtje të përhershme. Statistikat e përvitshme të kërkuara dërgohen në MASR sipas formateve dhe afateve të përcaktuara.</p> <p>Ecuria akademike e studentëve evidentohet plotësisht, disponohen regjistrat fizikë dhe elektronikë të matrikullimit, notave dhe diplomave të studentëve të cilët plotësohen ruhen dhe arkivohen konform legjisllacionit në fuqi.</p>

Standardi IV. 4- Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me statistikat e punësimit të studentëve që janë diplomuar pas përfundimit të programeve e studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.	
Kriteri 1 Institucioni mban një bazë të dhënash të studentëve të punësuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë apo të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë si dhe për vendet e punësimit të tyre;	Universiteti Aldent ka krijuar një rrjet online ku studentët e diplomuar janë pjesë përbërëse e tij dhe ndajnë eksperiencat e tyre në fushat përkatëse të studimit apo punësimit. Kjo database është në rishikim të vazhdueshëm pas çdo viti diplomimi. Përfaqësuesit e Zyrës së Karrierës organizojnë takime të herëpashershme me ish studentët e UAL dhe studentët e viteve të larta.
Kriteri 2 Institucioni mban një bazë të dhënash për studentët që vazhdojnë studimet e mëtejshme në ciklet e tjera të studimeve etj.	
Standardi IV. 5- Institucioni informon studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe të detajuar, në lidhje me programet e studimeve.	
Kriteri 1 Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programet e studimeve, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit, statusin e akreditimit të programit;	Studentët e Universitetit ALDENT informohen për të gjitha detajet e programit të studimit nëpërmjet faqeszyrtare e cila është aktive dhe përditësohet vazhdimisht nëpërmjet katalogëve të Universitetit. si dhe nëpërmjet platformës elektronike FxEducation
Kriteri 2 Studentët informohen për rezultatet e vlerësimit gjatë dhe në përfundim të programit;	Pedagogët kanë rolin e tyre në këtë drejtim në orët e parashikuara për tutoriatin UAL mban të informuar në kohë reale studentët çdo programi studimi lidhur me proceset e akreditimit, liçensimit, etj. Në grupet e vlerësimit të brendshëm gjatë procesit të akreditimit përfshihen studentët përfaqësues të qeverisë studentore.
Kriteri 3 Përgjegjësi i modulit diskuton hapur me studentët rezultatet e këtyre vlerësimeve.	Studentët që kur aplikojnë njihen paraprakisht me përmbajtjen e programit të studimit. Kjo bëhet ose në ëeb-in e universitetit ose direkt në e-mail-in personal dërgohen të dhënat kryesore mbiprogramin. E njëjta gjë bëhet edhe për dokumentacionin e liçensimit, akreditimit, etj. Këto të dhëna janë publike dhe të aksesueshme nga studentët dhe publiku. Studentët informohen vazhdimisht për rezultatet e tyre gjatë vitit (pikët në çdo komponent të vlerësimit) si dhe me rezultatet në provimin elëndëve dhe moduleve. Studentët që duan të diskutojnë rezultatet e tyre e kanë këtë mundësi me pedagogët përkatës.
Standardi IV. 6- Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.	
Kriteri 1 Institucioni u ofron këshillim studentëve, ndjek ecurinë e tyre dhe i ndihmon për trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave që lidhen me procesin mësimor;	Ka akses të studentëve në çdo kohë pranë personelit akademik e administrativ për çdo problem UAL ndjek në vazhdimësi ecurinë e studentëve gjatë procesit mësimor ashtu edhe gjatë praktikave mësimore. Grupet e masterit janë në përgjithësi të vogla, prandaj njihen shumë mirë nga tutorët e tyre, madje sipas tyre edhe me problematikat që mbart secili prej tyre.

<p>Kriteri 2 Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.</p>	<p>Përsa i përket praktikës profesionale institucioni i ndihmon studentët për të gjetur vendin e përshtatshëm. Kjo favorizohet edhe nga marrëveshjet e bashkëpunimit që ka UAL. Pedagogët e këtij programi njohin gjendjen reale të këtij shërbimi dhëmundësitë për pranimin e studentëve për praktikaprofesionale. Roli kryesor i Zyrës së Karrierës në UAL, në bashkëpunim me tutorët është që t'u vijë në ndihmë të gjithë studentëve, për zhvillimin e praktikës profesionale.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <p>Pranimet e studentëve në programin e studimit Msc. në Fizioterapi Klinike bëhen në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për IAL. Studentët e regjistruar informohen në mënyrë të detajuar nëpërmjet faqes zyrtare, katalogëve të Universitetit si dhe nëpërmjet platformës elektronike FxEducation për programin e studimit, kohëzgjatjen e tij, liçensimin dhe akreditimin e tij. Studentët në Universitetin "ALDENT" kanë një jetë aktive studentore dhe ndihen të përfaqësuar në vendimarrje. Zyra e Karrierës në UAL funksionon me eficiencë në mbështetje të studentëve. Institucioni disponon dokumentacionin përkatës për vlerësimin e dijeve të studentëve. Gjithashtu disponohen regjistrat fizikë dhe elektronikë të matrikullimit, notave dhe diplomave të studentëve të cilët plotësohen, ruhen dhe arkivohen konform legjislacionit dhe akteve nënligjore në fuqi.</p> <p><u>Standardet plotësohen</u></p>	

Rubrika 10 - KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.

Pjesa përshkrimore

Terma reference: politikat e kërkimit shkencor në këtë program studimi, botimet në vite, projektet e fituara dhe të realizuara, pjesëmarrja në aktivitetet brenda dhe jashtë vendit, aktivitetet e organizuara nga njësia, lidhja e kërkimit me mësimdhënien.

Universiteti Aldent është një institucion që konsideron krahas procesit mësimdhënies edhe kërkimin shkencor. Anëtarët e Departamentit të Infermierisë dhe Fizioterapisë marrin pjesë në mënyrë aktive në kongrese dhe konferenca si brenda, ashtu edhe jashtë vendit.

Krahas mësimdhënies e kërkimit shkencor, stafi akademik inkurajon studentët të përfshihen edhe në projekte apo të jenë pjesëmarrës në konferenca, seminare dhe ëorkshope si dhe nëpërmjet detyrave të kursit, eseve, hartimit të temave të ndryshme të bëjnë punë të pavarur.

Kërkimin shkencor në UAL mbështetet nga disa laboratore të pajisur me aparaturabashkëkohore dhe me materiale cilësore për realizimin e eksperimenteve apo të metodave të reja mjekuese.

Universiteti ALDENT ka një procedurë të brendshme, që realizohet në çdo fillim viti akademik e cila ka të bëjë me planifikimin e pjesëmarrjes në aktivitete shkencore, projekte dhe prezantime të ndryshme të stafit efektiv gjatë vitit akademik.

Këtë vit akademik Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike është paraqitur me tre projekte të cilat u vlerësuan dhe u aprovuan për zbatim nga Senati Akademik. Në të tre projektet është parashikuar pjesëmarrje aktive si të stafit akademik dhe të studentëve të programit të studimit Msc. në Fizioterapi Klinike.

UAL organizon Konferencën e përvitshme studentore, ku këta të fundit, të udhëhequr nga pedagogët paraqesin prezantime të punimeve të tyre. Programi i Fizioterapisë është përfaqësuar çdo vit nga studentët më të mirë. Gjithashtu studentët nxiten të marrin pjesë jo vetëm në aktivitetet shkencore brenda institucionit, por edhe në ato institucione me të cilat UAL ka bashkëpunim.

- Të dhëna për kërkimin shkencor gjenden në Anekse, tabela 21

Ka aktivitet kërkimor shkencor, referime dhe botime në aktivitete shkencore kombëtare e nderkombëtare. Pjesëmarrja në këto aktivitete me referime shkencore është e kënaqshme. Sidoqoftë ajo që duhet të synohet është shtimi i nr. të botimeve nga kërkuesit-pedagogët në revistat e periodikët brenda e jashtë vendit.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi III.3 - Personeli akademik angazhohet në veprimtari shkencore të organizuara në kuadër të programit të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik publikon rregullisht artikuj, materiale shkencore në disiplinën përkatëse;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik, nëpërmjet angazhimeve në këto veprimtari jep ndihmesën e tij në zhvillimin e shkencës ose në zhvillimin e sektorëve të prodhimit apo të shërbimit.</p>	<p>Ka publikime të personelit akademik, megjithatë ajo që duhet të synohet është shtimi i nr. të botimeve nga kërkuesit-pedagogët në revistat e periodikët brenda e jashtë vendit.</p> <p>Kurse pjesëmarrja në aktivitete shkencore me referime shkencore është e kënaqshme.</p> <p>Studimet e kryera nga personeli akademik vlersohen për të analizuar dhe kuptuar situatën aktuale dhe zhvillimet në fushën studimore përkatëse. Stafi i Aldent ndihmon në formimin në vazhdim të profesionistëve të mjekësisë të të gjitha fushave duke përfshirë edhe fizioterapinë. Janë organizuar trajnime të ndryshme me pjesëmarrje të fizioterapistëve ngavendi por edhe nga vendet fqinje si Kosova, Maqedonia, Mali i Zi, etj. Kjo ka ndikuar në ngritjen e nivelit shkencor të profesionistëve të fushës si dhe në aplikimin e metodave të reja.</p>
Standardi III.4 - Institucioni ofron programe mësimdhënieje edhe në gjuhë të huaj, me një personel akademik të kualifikuar.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka kryer studimet universitare në atë gjuhë ose zotëron një certificate për njohje të avancuar të saj;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka një përvojë në mësimdhënie në atë gjuhë, prej së paku një semestri.</p>	<p>Mësimi në Universitetin Aldent zhvillohet vetëm në gjuhën shqipe por studentët shfytëzojnë literaturë bashkëkohore të huaj që i vihet në dispozicion nga vetë institucioni.</p>
Standardi III.10 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimorshkencor;</p>	<p>GVJ ju komunikua gjatë vizites në vend se Institucioni ka organizuar në vazhdimësi programe specifike për trajnim profesional të personelit si në fushën akademike ashtu edhe profesionale.</p>

<p>Kriteri 2 Institucioni u ofron personelit akademik dhe atij mësimor-shkencor mundësinë e kualifikimeve të mëtejshme brenda dhe jashtë vendit.</p>	<p>Janë organizuar trajnime me profesorë të pedagogjisë, sociologjisë apo psikologjisë për mënyrat e mësimdhënies, marrëdhëniet me studentët, pacientët, etj. Po ashtu janë organizuar trajnime profesionale brenda UAL me referues nga stafi apo të ftuar. Është nxitur pjesëmarrja e stafit në trajnime apo konferenca shkencore, është siguruar literatura bashkëkohore profesionale sipas kërkesave të stafit.</p> <p>Është nxitur dhe sponsorizuar pjesëmarrja e stafit në kualifikime të ndryshme brenda e jashtë vendit.</p>
<p>Standardi III.11 - Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me veprimtarinë kërkimore-shkencore të personelit akademik të tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të studimeve shkencore të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon një bazë të dhënash për botimet (tekste, monografi, libra, artikuj apo kumtesa në konferenca) brenda e jashtë vendit të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni disponon një bazë të dhënash për projektet kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë ose merr pjesë personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi.</p>	<p>Disponohen për cdo anëtar të stafit akademik të departamentit të Infermierisë dhe Fizioterapisë dosjet personale mepërmbajtjen e të gjithë punimeve shkencore dhe certifikatave të trajnimeve ku kanë marrë pjesë.</p> <p>UAL ka një databazë të dhënash për botimet e referimet shkencore të stafit akademik të cilat rinovohen vazhdimisht për secilin anëtar.</p> <p>Institucioni disponon të dhëna të pakta mbi projektet sidomos kërkimore që aktualisht janë në proces dhe drejtohen nga personeli i këtij programi studimi cka lidhet edhe me faktin që është program i ri.</p>
<p>Konkluzionet e vlerësimit: Personeli akademik publikon punime në revista brenda dhe jashtë vendit, merr pjesë rregullisht në konferenca, seminare, kongrese brenda dhe jashtë vendit me prezantime orale, postera etj duke synuar realizimin e objektivave personale, edukimin në vazhdimësi dhe kontribuar në zhvillimin e kërkimit shkencor të universitetit dhe mjekësisë në përgjithësi. Institucioni nxit dhe përkrah edhe financiarisht cdo projekt të vlefshëm që ndërmerret nga stafi dhe studentët. Cdo anëtar i departamentit disponon dosjen personale me përmbajtjen e të gjithë punimeve shkencore dhe certifikatave të trajnimeve kukanë marrë pjesë. Në të ardhmen duhet synuar në shtimin e botimeve në revista e periodikë.</p>	
<p>Standardet plotësohen</p>	

Rubrika 11 - Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun

